

HEJZA

Gersa RRUDHA

Letërsia të jep shijen dhe bukurinë estetike dhe shpirtërore, kurse filozofia është i vetmi instrument i sigurt i formimit më të shëndoshë mendor, për të cilin ka aq shumë nevojë realiteti shqiptar

KULTURA NUK ËSHTË SEZONALE!

Një organizatë kulturore e përgjegjshme, me politika të qarta që mundësojnë avancimin kulturor në jetën e përgjithshme, përmes programit të vet kulturor do të synonte të kapte majat e institucioneve të suksesshme kulturore, duke ia siguruar vetes një status sa më të lartë në sistemin kulturor

Avni HALIMI

Çka duhet të synojnë shoqatat apo organizatat kulturore gjatë zbatimit të projekteve të parapara në programet e tyre kulturore? A është synim realizimi i qëllimit: përfundimi me sukses i aktiviteteve kulturore? Po, kështu rezonojnë boss-ët kulturorë, të cilët kanë themeluar organizata duke i konceptuar ato si tezga fruta-perimesh që duhet të shiten deri në mbrëmje dhe në shtëpi të shkohet me fitimin e pastër!

Një organizatë kulturore e përgjegjshme, me politika të qarta që mundësojnë avancimin kulturor në jetën e përgjithshme, përmes programit të vet kulturor do të synonte të kapte majat e institucioneve të suksesshme kulturore, duke ia siguruar vetes një status sa më të lartë në sistemin kulturor. Ky angazhim kulmor i një organizate të tillë, në fakt vetes do t'i siguronte një rol dhe detyrë por edhe një mundësi reale për t'u inkuadruar nëpër debate kulturo-

ro-politike, të promovojë ide të shëndosha, të qëndrueshme dhe estetike si dhe të kontribuojë për ngritjen e standardeve profesionale.

Pothuajse nuk na kalon javë pa organizuar orë e takime letrare, manifestime e festivale teatrale, filmike, muzikore, nuk na kalon javë pa ndonjë koncert muzikor-folklorik etj. Janë edhe po aq organizime për të cilat nuk dëgjojmë asnjë fjalë, sikur turpërohemi prej atyre organizimeve "kulturore", asnjë shënim në ndonjë mjet nacional informimi! Dikush mendon se me rëndësi është që të bëjmë diçka në sferën e kulturës dhe jo të informojmë se çka u bë në këtë rrafsh!

Shoqëritë e civilizuara nuk ndër-marrin asnjë lëvizje kulturore pa e siguruar paraprakisht informimin i cili duhet të shkojë te çdo qytetar lidhur me aktivitetin kulturor që është ndërmarrë. Me këtë akt, organizatat kulturore jo që nuk tolerojnë që të mbahet në fshehtësi aktiviteti i tyre, por, ato synojnë që duke dalë në publik të sigurojnë vende sa më të

larta në sistemin kulturor. Ky duhet të jetë synimi final i shoqatave apo i organizatave tona kulturore. Fatkeqësisht, me përfundimin e projektit nga shoqatat apo organizatat tona nga rrafshi kulturor, përfundon gjithçka, eventualisht duke lëshuar ndonjë komunikatë për opinion sa për të kumtuar se, me këtë pikë artistike mori fund projekti kulturor! Asnjë organizim tjetër as për të debatuar mbi manifestimin apo festivalin që përfundoi, as për të kumtuar ndonjë rezultat, ndonjë të arritur, as për të folur mbi qëllimin, mbi identifikimin e problemeve të reja që dolën në sipërfaqe përgjatë realizimit të projektit etj.

Edhe komunikimi me opinionin pos-manifestimit apo post-festivalit është kulturë, është dëshmi e seriozitetit dhe profesionalizmit të akcilës organizatë në sferën e kulturës. Drejtuesit e këtyre organizatave që zhvillojnë ndonjë aktivitet kulturor dhe, e fshehin atë prej opinionin për ta harruar sa më shpejtë, shkaktojnë dyshime për ndonjë fajt

eventual të tyre! Fshehja e këtyre aktiviteteve nga opinioni i gjerë, ka të bëjë, mbi të gjitha, me kriminalizimin e "zhvillimeve kulturore"! Janë marrë lekët, është bërë një aktivitet sa për sy e faqe, është dorëzuar një raport narrativ, jo profesionalisht i mbështetur me fatura e vërtetime fiskale dhe, prandaj, bëhet mirë sikur të heshtet sa më parë! Kësisoj, këto organizata kulturore shërbejnë për ta pasuruar pronarin e "sipërmarrjes" dhe jo edhe për ta begatuar jetën kulturore.

Kultura nuk është sezonale apo javore, apo dy-tri orë lexim poezish, recitim patetik e aktrim arlekinësh! Kulturë nënkuptohet edhe debati i përditshëm për dhe rreth kulturës, për proceset kulturore apo për mungesën totale të jetës kulturore në shoqëri. Kulturë është edhe ndërgjegjësimi i mediave që debatin, emisionin kulturor, faqen kulturore, mos ta konceptojnë si "ngjarje kulturore" ad hoc, porse program kombëtar mediatik.




JERZY GROTOWSKI

ARTI

Po përse sakrifikojmë kaq shumë energji për artin tonë? Jo për t'iu imponuar të tjerëve, por për të mësuar së bashku me ta se ç'mund të na japë ekzistenca jonë, organizmi ynë, eksperiencia jonë personale dhe e papërsëritshme; për të mësuar të shkatërrojmë pengesat që na rrethojnë dhe për të liru veten nga frerët, nga gënjeshttrat të cilat i prodhojmë çdo ditë për veten dhe për të tjerët; për të shkatërruar kufizimet e shkaktuara nga injoranca jonë dhe mungesa e kurajës. Me pak fjalë, për të mbushur boshllëkun që ndiejmë brenda vetes, për t'u realizuar. Arti nuk është as një gjendje e caktuar e shpirtit (në kuptimin e ndonjë çasti frymëzimi hyjnor e të jashtëzakonshëm) dhe as ndonjë pozicion i posaçëm i njeriut (në kuptimin profesional dhe shoqëror). Arti është një maturim, një evoluim, një zbulim që na aftëson të dalim nga errësira nën një rreze drite...

Chat GPT

Chat GPT është një model i inteligjencës artificiale, me një aftësi të mahnitshme për të kuptuar tekstin në formë të lirë të shkruar nga njeriu



Enver BUÇAJ

Në të ardhmen e afërt, me përdorimin e inteligjencës artificiale do të ketë aq shumë mundësi të sofistikuar të kësaj platforme, aq sa vetëm pak vite më parë e tërë kjo do të jetë parë krejtësisht në anën e fantashkencës.

Teknologjia ndërkombëtare është tronditur nga Chat GPT, i publikuar nga Fondacioni Open AI. Chat GPT është një model i inteligjencës artificiale, me një aftësi të mahnitshme për të kuptuar tekstin në formë të lirë të shkruar nga njeriu. Një version falas sa për ta provuar u lëshua kohët e fundit për publikun e gjerë dhe është i disponueshëm në faqen e internetit Open AI. Nuk është ekzagjerim ta quash që ky është një model REVOLUCIONAR.

Deri më tani nuk është dëgjuar që një kompjuter mund të reagojë në mënyrë kaq fleksibile ndaj komandave të paraqitura në një formë jo të strukturuar, të tilla si: "ma shkruani një poezi për Prishtinën", "shkruani një ese apo përmbledhje me temën e caktuar", "paraqisni një tabelë të liqeneve më të mëdhenj në botë" ose "shkruani një punim shkencor për temën e caktuar, apo shkruani biografinë për mua", apo edhe shumë e shumë mundësi të tjera për projekte të ndryshme. Pasojat janë më të gjëra se sa mund të mendohet deri më tani - nuk është e paramenduar që ato të vendosin mënyrën tonë të jetesës në një besim të ri.

Ndërsa mënyra e natyrshme e komunikimit të një personi është të folurit me rrjedhje të lirë, një kompjuter kupton vetëm të dhëna të formuluar me saktësi ekstreme përmes tekstit ose një ndërfaqe përdoruesi të para-ndërtuar. Një arsye e madhe pse profesionet e zhvilluesve të programeve kompjuterike të mjekëve apo avokatëve nuk janë automatizuar, është pikërisht kjo pengesë gjuhësore mes

njeriut dhe kompjuterit. Chat GPT e kalon këtë kufi dhe hyn në një zonë që përdoret për t'u parë si territori i një personi që kryen punë informative.

Gjërat po ecin më shpejt nga sa pritej

Shumë shpejt ka mundësi të zhvillohen aplikime të reja që vetëm pak vite më parë ishin rreptësisht në anën e fantashkencës. Megjithatë, ato janë vetëm ana tjetër e medaljes, pasi ka të paktën po aq objektiva aplikimi të dyshimta nga pikëpamja etike. Për shembull, monitorimi masiv i opinioneve të ndryshme politike mund të arrihet lehtësisht me Chat GPT. Është e lehtë të gjesh shembuj shqetësues si fushata dezinformuese, mesazhe mashtruese adaptive, robotë marketingu që reagojnë ndaj sjelljes së internetit, llogari të mediave sociale që pretendojnë të jenë një person tjetër etj. Tashmë në vitet e ardhshme, mund të jetë e pamundur të thuash nëse teksti i gjetur në internet është shkruar nga një njeri, nëse partneri bisedues i gjetur në komente ekziston me të vërtetë dhe çfarë përfundimi do të arrijë inteligjenca artificiale që vëzhgon anash për t'u bazuar në komentet tuaja.

Gjërat tani po ecin më shpejt nga sa mund të priste dikush. Edhe studiuesit në këtë fushë nuk mund të parashikojnë që modelet si Chat GPT do të bëheshin kaq inteligjente dhe kaq shpejt. Më në fund është koha për t'u zgjuar dhe për të menduar se çfarë do të thotë e gjithë kjo.

Aplikacionet e Open AI si Chat GPT po ndryshojnë rrënjësisht mënyrën se si funksionojnë shkollat e mesme dhe universitetet. Sasia e informacionit dhe aftësia e Chat GPT për të mbajtur biseda janë mbresëlënëse dhe të paparë deri më tani. Ajo që

është veçanërisht e habitshme është aftësia e inteligjencës artificiale për të shkruar me komandë tekst bindës dhe kryesisht të bazuar në fakte, pavarësisht nga lloji i tekstit në disa gjuhë të ndryshme të botës. Të paktën për momentin, inteligjenca artificiale e cila është e hapur dhe falas mund të përdoret për të shkruar gjithçka, nga aplikimet për punë, poezitë e dashurisë dhe reklamata zgjedhore e deri të emaillet zyrtare dhe deklaratat politike. Dhe mbi të gjitha, mund të shkruan të gjitha tekstet e kërkuara në shkolla fillore, shkolla të mesme dhe universitete, nga esetë deri të përmbledhjet dhe punimet e diplomës.

Është e habitshme se sa pak vëmendje i është kushtuar diskutimit rreth Chat GPT, sepse implikimet e tij janë revolucionare për arsimin në disa fusha. Për shembull, studimet e shkencave sociale në universitet për vite me radhë janë fokusuar kryesisht në shkrimin e eseve, përmbledhjeve dhe tezave përfundimtare. Ato kryhen në mënyrë të pavarur dhe kthehen në platformën e kurseve të universitetit. Megjithëse keqpërdorues të ndryshëm komercialë për shkrimin e eseve, temave të diplomave kanë qenë në dispozicion të studentëve për disa vite me çmime të ndryshme dhe me cilësi të dobët.

Chat GPT e ndryshon në mënyrë specifike këtë cilësim, duke e sjellë mashtrimin falas në kompjuterin e vetë studentit me vetëm disa klikime dhe komanda. Nëse studenti nuk dëshiron të përdorë si të tillë tekstin e krijuar nga inteligjenca artificiale, ai të paktën i jep studentit një bazë të fortë, strukturore të punimit.

Përfundimi i studimeve më i lehtë se kurrë

Shkrimet e opinioneve kanë shqyrtuar nëse inteligjenca artificiale

shkruan me mjeshtëri apo jo. Megjithatë, në praktikë aktualisht është e pamundur që mësuesi dhe profesori të njohë përgjigjet e esesë të krijuara nga vetë Chat GPT si të bëra nga kompjuteri. Për sa i përket cilësisë, ato madje plotësojnë kërkesat minimale për një përgjigje eseistike të nivelit të diplomuar në universitete.

Inteligjenca artificiale vështirë se do të ndikojë në jetën e atyre që janë vërtet të interesuar për studimet e tyre. Ndryshimi më i madh është në grupin që dëshiron të përfundojë sa më shpejt studimet dhe të marrë diplomën në dorë, pavarësisht mjeteve. Përfundimi i studimeve tuaja shpejt bëhet - të paktën përkohësisht - më i lehtë se kurrë. Tani do të ishte më së voni koha për të ndryshuar qëndrimin tonë admirues ndaj përfundimit të shpejtë të studimeve për të qetësuar studimin, të menduarit dhe respektin përsëri.

Mund të pritët që të rinjtë të përvetësojnë teknologjinë e re për përdorimin e tyre mjaft shpejt, përdorin mesimdhënësit dhe institucionet arsimore janë shumë pas. Shpikja e metodave të reja të performancës dhe vlerësimit ndoshta do të marrë shumë kohë nga institucionet arsimore dhe së pari kërkon një ndërgjegjësim të përbashkët për problemet e reja që paraqet inteligjenca artificiale. Sidoqoftë, udhëheqësi i Open AI z. Sam Altman deklaroi së fundi se ka ende shumë punë për të bërë me inteligjencën artificiale dhe "është gabim t'i besosh asaj [Chat GPT] për çdo gjë të rëndësishme tani".

Është e qartë se inteligjenca artificiale po ndryshon natyrën e punës së njohurive. Ndoshta tashmë në të ardhmen e afërt, puna e informacionit me një nivel të ulët abstraksioni, siç është korrigjimi dhe përmbledhja e tekstit, mund të bëhet në një masë të madhe me ndihmën e inteligjencës artificiale.

PËRKRHAJA MË E MADHE NA ERDHI NGA KOSOVA

Është për të ardhur keq që shqiptarët e Maqedonisë së Veriut shumë pak e përkrahën këtë iniciativë. Gjithashtu edhe institucionet (shqiptare) e kësaj Republike nuk kanë dhënë asnjë përkrahje, me përjashtim të kryetarit të Gostivarit, z. Arben Taravari, që na dhuroi 500 libra.

Bisedoi: Fitim A. NUHIU

Emira Selimi, nga Shkupi, studion Shkenca Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Universitetin e Europës Juglindore. Ajo është nismëtare për hapjen e një biblioteke me libra shqip në qytetin e Manastirit, qytet ky me një rëndësi të veçantë për shqiptarët, sepse pikërisht këtu, siç dihet, në vitin 1908, u mbajt Kongresi i Alfabetit të gjuhës shqipe. Nisma e Emirës bëri jehonë të madhe, kurse këtë e dëshmon fakti se në forma të ndryshme, janë dhuruar me mijëra e mijëra libra.



Çka ju lidh me Manastirin?

Në vitin 2021 fillova të bëj një hulumtim në qytetin e Manastirit në lidhje me shqiptarët e besimit ortodoks, gjegjësisht më interesonte familja Qiriaz. Kjo familje jeton në Manastir, por nuk e flasin gjuhën shqipe, edhe pse deklarohen me kombësi shqiptare, pavarësisht presioneve të shumta që i kanë pasur nga pushteti maqedonas. Ata nuk ngurrojnë të deklarojnë identitetin e tyre. Ndërkohë që bëja këtë hulumtim, vazhdoja të zgjeroja hulumtimin tim edhe me shqiptarët e besimit islam, që deklarohen shqiptarë. Aty realisht u gjenda para një situatë shumë të mjerë, të një propagande të madhe sllave kundrejt shqiptarëve në atë qytet, që

përpiqen të mbulojnë dhe t'ua mohojnë identitetin, duke u munduar që t'i tjetërsojnë nga shqiptarë në sllavë. Sipas statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në qytetin e Manastirit nga numri i përgjithshëm i banorëve, afër 2 % janë shqiptarë. Në këtë qytet ka edhe shqiptarë me mbiemra të sllavizuar (e që nuk njihen si shqiptarë).

Pse bibliotekë me libra shqip në Manastir?

Para një muaji, kishim një tubim kom-

shkollë fillore, e quajtur "Goce Delçev", që për fat të keq, dita ditës po zbrazet nga nxënësit shqiptarë dhe po shkojnë për t'u regjistruar në shkollat maqedonase. Vlen të përmendet se për nevojat e kësaj shkolle fillore kam arritur të siguroj disa libra, duke përfshirë këtu Abetaren e Republikës së Shqipërisë, librat e gjuhës shqipe dhe librat e lëndës së historisë. E vetmja mënyrë dhe e vetmja alternativë për ta ruajtur identitetin kombëtar, është hapja e e një biblioteke, sepse aty ku ruhet gjuha, aty ruhet edhe identiteti. Shqiptarët në Manastir janë të interesuar, janë atdhedashës dhe mendojnë që të shkojnë të lexojnë, që ta mbrojnë gjuhën, ta mësojnë historinë e tyre në mënyrë sa më të mirë, duke mësuar dhe lexuar nga librat që po i sigurojnë dhe po i sjellin bashkëkombësit nga të gjitha trojet shqiptare.

Po rrugët ligjore për hapjen e kësaj biblioteke i keni ndjekur? Ku do të jetë lokacioni i kësaj biblioteke? Po stafi që do të merret me regjistrimin, klasifikimin etj, i keni menduar të gjitha këto?

Qysh kur lindi ideja jam konsultuar me drejtorin e Muzeut të Alfabetit në Manastir, Zait Aliun dhe mendoj që kemi të drejtë të plotë ligjore që bibliotekën ta hapim në katin e parë të Muzeut të Alfabetit, aty ku edhe u themelua alfabeti i shqiptarëve. Do të ishte dinjitoze që të rikthehet rëndësia e saj historike duke u hapur kjo bibliotekë pikërisht në shtëpinë e shenjtë të shqiptarëve. Vlen të ceket se më herët në këtë hapësirë janë shitur pllaka dhe qeramikë, dhe se hapësira tani është e zbrazët. Sërish mendohet që kjo hapësirë të jepet për biznese të vogla, por kjo gjë nuk do të mund të ndodhë më. Nuk do të lejojmë që të përdhosen ky institucion historik mbarëshqiptar. Drejtori i Muzeut ka kërkuar nga Ministria e Financave që të punësojë një punëtor në bibliotekë. Edhe unë, herë pas here do të jem e pranishme në Manastir në cilësinë e koordinatorës. Po ashtu kemi planifikuar që biblioteka e Manastirit të ketë sistemin e njëjtë sikur biblioteka Max Van der Stoel e Universitetit të Europës Juglindore, çka do të thotë se të gjitha të jenë të sistemuara në mënyrë elektronike dhe secili që dëshiron të marrë libra nga kjo bibliotekë, duhet të regjistrohet (email adresa, telefoni, adresa shtëpiake, etj).

A keni pasur përkrahje nga Shqipëria, Kosova, nga institucionet në Maqedoninë e Veriut?

Kemi pasur përkrahje nga Shqipëria, mirëpo përkrahja më e madhe na erdhi nga Kosova. Qysh në fillim të kësaj iniciative, më mori në telefon një mërgimtar nga Istogu që jeton dhe punon në Norvegji dhe më tha se do t'i

dhurojë 1300 libra për bibliotekën e Manastirit. Është për të ardhur keq që shqiptarët e Maqedonisë së Veriut shumë pak e përkrahën këtë iniciativë. Gjithashtu edhe institucionet (shqiptare) e kësaj Republike nuk kanë dhënë asnjë përkrahje, me përjashtim të kryetarit të Gostivarit, z. Arben Taravari, që na dhuroi 500 libra.

A mendoni se kjo nismë personale e juaja dëshmon për dështimin e strategjive mbarëkombëtare?

Mendoj se kjo nismë i ka dhënë për herë të parë zë këtij qyteti. Zëri i tyre i vërtetë po dëgjohet nëpër të gjitha trojet shqiptare. Është për t'u habitur se si më parë Tirana zyrtare e ka neglizhuar këtë qytet të shenjtë të historisë sonë kombëtare. Akoma habitem nëse e ka ditur Tirana zyrtare se Shtëpia e Alfabetit ka qenë pothuaj 1 vjet pa rrymë elektrike. Jemi poshtëruar në formën më të keqe të mundshme dhe nuk është dëgjuar reagimi as nga Republika e Shqipërisë, e as nga Republika e Kosovës, kurse për shqiptarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të mos flasim fare. Jam shumë optimiste dhe nuk do të shmangem nga kjo iniciativë, pavarësisht pengesave që do të paraqiten.

A mund të themi se te studentët e sotëm është rigjallëruar ëndrra e rilindësve tanë?

Sigurisht që po. Pothuajse çdo vit organizoj udhëtime për studentë nga Shkupi për në Manastir. Kur e bëj përzgjedhjen e tyre, i zgjedh ata studentë që nuk kanë qenë asnjëherë në Manastir, që t'iu mundësohet për ta vizituar e për ta njohur nga afër atë muze të shenjtë dhe për t'i thënë të gjithëve se ky muze nuk duhet vizituar vetëm për 22 nëntor, por të vizitohet më shpesh, sa herë që t'iu jepet mundësia.


Nisma juaj është sa simbolike aq edhe fisnike. A mendoni se do të mund t'i rikthehet sado pak lavdia e dikurshme e këtij qyteti, që në historinë e popullit shqiptar zë një kaptinë të veçantë?

Nëse e vizitoni këtë qytet, ju menjëherë do të vëreni te shqiptarët e këtij qyteti dy gjëra: frikën dhe faktin se nuk e flasin mirë gjuhën shqipe. Kjo është sa e dhimbshme aq edhe ironike. Qyteti i Alfabetit shqip që nuk e di gjuhën shqipe. Unë besoj se kjo bibliotekë do të mundësojë që shqiptarët e këtushëm ta njohin më mirë gjuhën e pastër shqipe. Duhet potencuar se Manastiri do të jetë i vetmi qytet në Maqedoninë e Veriut që do të fillojë të mësojë nga abetarja e Republikës së Shqipërisë dhe besoj fort se gjeneratat e ardhshme me trenari do ta kujtojnë dhe nuk do ta harrojnë lavdinë e dikurshme kombëtare dhe se gjërat do të ndryshojnë për të mirë.

Një lajm që s'u bë kryelajm

LIBRI DHE SHKRIMTARI

Të gjithë e dimë tashmë se indiferenca totale e shtetit, nënvleftësimi i hapur krijuesve dhe trajtimi i tyre si apendiks me vite dhe dekada, i sollën një dëm të konsiderueshëm letërsisë sonë kontemporane



Agim BAJRAMI

Pak ditë më parë lexova lajmin se një grup lexuesish të rinj i kishin bërë ftesë një shkrimtari të njohur, për të diskutuar bashkërisht për disa nga veprat e tij më të njohura. Do të ishte një takim, jo nga ata që jemi mësuar të shikojmë gjer më tani, të llojit ex katedra ku lexuesi bën pyetje dhe shkrimtari përgjigjet, por një bashkëbisedim profesional, ku shkrimtari dhe lexuesit do të tentojnë të plotësojnë njeri tjetrin, në çdo detaj. Edhe pse kjo veprimtari ishte iniciuar nga një politikan vendor dashamirës dhe bashkëqytetar i autorit, në kushtet në të cilën ndodhet libri dhe leximi i tij në vendin tonë, kjo gjë më duket një ogur i mirë.

Them kështu, pasi e shoh si diçka pozitive, që më në fund politika dhe shoqëria, edhe pse shumë ngadalë, po i kthejnë sytë më me respekt nga letërsia dhe kultura kombëtare, duke u bindur se shkrimtari nuk mund të trajtohet si gjer më tash, si apendiks

për politikën dhe strategjitë e tyre kulturore jo efikase. Në një gjykim më të thellë duket se qëndrimet e tyre të ngurta dhe ideja aspak dashamirëse: se me librin duhet të merren vetëm botuesit dhe autorët e librave gjatë ditëve të panairit ose gjatë muajit të letërsisë, kanë filluar të pësojnë një krisje.

Të gjithë e dimë tashmë se indiferenca totale e shtetit, nënvleftësimi i hapur krijuesve dhe trajtimi i tyre si apendiks me vite dhe dekada, i sollën një dëm të konsiderueshëm letërsisë sonë kontemporane. Qëndrime të tilla shkaktuan edhe një largim masiv të lexuesit nga shkrimtarët dhe letërsia e tyre e preferuar kombëtare. Kjo bëri që boshllëkun e tyre ta zinin përkthimet masive dhe të nxituara nga lloj-lloj diletantësh dhe tregtarësh të babëzitur librash, të ashtuquajtura bestseller, si nga letërsia e huaj, ashtu dhe ajo e kalemshinjeve shqiptarë që, përveç shijes së tyre limonadë, nuk

reflektonin asnjë vlerë të mirëfilltë artistike dhe estetike tek lexuesi i angazhuar, duke e çorientuar atë keq konceptin për librin dhe për shkrimtarin, sa erdhi një periudhë që po të thoje jam shkrimtar, të shikonin me keqardhje.

Një klimë e tillë fatkeqësisht vazhdon të jetë prezent edhe sot e kësaj dite, megjithë ca lëvizje të vogla e të druajtura, që duhet thënë se nuk janë ende të mjaftueshme. Është fakt i pakundërshtueshëm, që një shoqëri që nuk e do librin dhe s'di të vlerësojë shkrimtarët e saj të vërtetë, është një shoqëri e rrezikuar nga terri dhe obskurantizmi i injorancës. Ndonëse jemi në kushtet ku vendosja e urave të komunikimit mes lexuesve dhe autorëve me vlerë është bërë një mision jo fort i lehtë, unë mendoj se asgjë nuk është e pamundur në këtë fushë. Shtimi i nismave dhe kërkimi i alternativave, për të dalë sa më shpejt nga kjo situatë e rëndë ku ndodhet libri dhe lexuesi i saj, duhet

patjetër të shoqërohet nga një rishikim emergjent i strategjive dhe politikave kulturore të ndjekura gjer më tani, me mendje të hapur dhe vizionare.

Në situatën e sotme ku si heronj të ditës lansohen vetëm politikanë perversë dhe bosë droge, këngëtarë tallavaje dhe repera rrugaçë, në kushtet ekstreme, ku një brez i tërë helmohet çdo çast nga kronikat e zezë të krimi, prostitucionit dhe big-brotherit, lajmi për takim të lexuesve të rinj me shkrimtarin e tyre të preferuar larg formateve dhe skemave të deritanishme, duhet konsiderohet një hap i mirë dhe i shumëpritur, për daljen e librit nga pozicioni i mbyllur ku rrinte gjer më tash, duke zënë vendin që i takon në sytë dhe duart e lexuesit. Një lajm i tillë që meriton të bëhet menjëherë krye-lajm, meriton edhe të duartrokitet. Dhëntë zoti që kjo gjë të mos mbetet vetëm një rast i veçuar, por të shërbejë edhe si një moment i mirë për reflektim...

Për kë bien kambanat!

LEHTËSIA E SHKATËRRIMIT TË GJUHËS

Të vjen me të vërtetë keq se si një komb, në fakt pjesa më e madhe e tij, sillet ndaj gjuhës së tij (saktësisht ndaj vetës së tij), me saq shumë injorancë dhe analfabetizëm

Fehmi AJVAZI

Fillim shekulli XXI, ka ndryshuar qasjet, sjelljet, vizionet dhe perspektivat e grupeve, shoqërive, kombeve kudo në botë. Janë valë ndryshimi të pandërprera që vijnë sa nga kërkesat dhe interesat e prodhimit dhe konsumit, dhe sa nga kërkesat politike, ideologjike, ekonomike, teknologjike etj. Në mes të këtyre ndryshimeve, disa prej të cilave të domosdoshme dhe pozitive, ka të tjera ndryshime që janë totalisht të pakontrolluara dhe të lëna në dorën e atyre që s'kuptojnë as vet se çfarë janë duke bërë. Ndër ata që "s'kuptojnë se çfarë janë duke bërë", jemi ne, shqiptarët, që të dalë në shekullin XXI me plagë ndër këmbë dhe me dhjetëra e qindra mungesa në çdo fushë shoqërore dhe nacionale, s'arrijmë të kuptojmë se çfarë është e mirë për ne dhe çfarë është e dëmshme. Në këtë aspekt, nga shumë dukuri dhe fenomene me prefikse negative, rreth e rrotull, ndikimet e pakontrolluara dhe çoroditëse janë ato që më së shumti e godasin identitetin, historinë dhe kulturën. Këto goditje, vërtetë janë deri aty sa, s'do të duhej të toleroheshin më tutje. Nga më të paskrupulltat, janë goditjet që i bëhen gjuhës – të folmes shqipe.

A kemi të bëjmë me një fenomen

alarmant? Çfarë po ndodh me gjuhën shqipe, me të folmen lokale dhe nacionale, me të shkruarit e saj publik: në libra, në institucione publike, në sheshe dhe rrugë, në dokumente të ndryshme, veçanërisht në rrjetet sociale, në facebook...? Ashtu si edhe disa fusha të tjera, si për shembull administrata, sistemi privat i arsimit, mediat shqip, fusha e botimeve, planifikimi urban, gjuha shqipe – e folme dhe e shkruar (në jetën private dhe publike) tërësisht i është lënë stihisë! Sintaksa dhe veçanërisht fonema dhe leksiku gjuhësor shqip, kanë hyrë në një fazë jashtëzakonisht të rrezikshme me përmasa të thella devijimi, deformimi dhe ndryshimi. Ndryshe nga e kaluara kur prania e lokalizmave gjuhësorë ishte e kuptueshme për shkak të ndasive politike dhe shtetërore dhe për shkak të mungesës së madhe të komunikimit ndërnjerëzor e ndërnacional që shkaktonte probleme në këtë drejtim, megjithatë do të jetë Kongresi i Drejtshkrimit (Tiranë, 1972), ai që do ta vendosë standardin e gjuhës. E tani, çfarë ndodh në epokën kur barrierat e mësipërme janë zhbërë dhe pengesat e komunikimit dhe të qarkullimit s'ekzistojnë...?

Të vjen me të vërtetë keq se si një

komb, në fakt pjesa më e madhe e tij, sillet ndaj gjuhës së tij (saktësisht ndaj vetës së tij), me saq shumë injorancë dhe analfabetizëm. Injoranca përkon me lehtësinë e mosrespektimit dhe të shkatërrimit të të folmes – gjuhës, dhe analfabetizmi përkon me mosnjohjen dhe deformimin e madh të gjuhës. E para vjen si rezultat i mungesës së vetëdijes kolektive mbi atributet kryesore të përkatësitë etnike, dhe e dyta vjen si rezultat i mos mësimi dhe i mosrespektimit të gjuhës së folme dhe të shkruar. Në kuptimin më të thjeshtë, gjuha jonë ka filluar ta ndjejë lehtësinë e kontaminimit të saj: qoftë në kuadër të deformimeve edhe më të thella lokale, dhe qoftë në kuadër të deformimeve të dialekteve (dialektit toskë dhe dialektit gegë).

Shtirati dhe pasuria më e madhe etno-nacionale, pas territorit, gjuha shqipe ka hyrë në një gjendje alarmante të çoroditjes dhe dobësimi substancial të saj. Në tri drejtime të theksueshme gjuha shqipe po rrezikohet gjithnjë e më shumë: nga depërtimet e fjalëve dhe shprehjeve të huaja (angleze, italiane, turko-arabe dhe greke), nga rikthimi dhe depërtimi i formave kulturore – mediale (muzika – kushtimisht e ashtuquajtura linja

"rep", botimet e pakontrolluara, të ashtuquajturat "show programe" në televizione, debatet e ndryshme krejtësisht të lira – të frustruara për nga e folmja publike, serialet televizive, komentimet në rrjetet sociale etj.) dhe gjuha ekonomike që vjen s'i rrjedhojë e produkteve, e marketingut, e prodhimeve, e teknologjisë etj. Kur këtyre "mostrave" ua shtojmë edhe lirinë e sjelljeve dhe kulturën agresive që e hasim kudo (natyrisht përmes gjuhës si atribut mendorë dhe fizik dhe 'gjuhës së trupit'), që prej njerëzve të thjeshtë e deri te elitat kulturore, biznesmenët, politikanët, administratorët, studiuesit, predikuesit e fesë etj., s'ka koment: gjuha shqipe ndodhet në një gjendje të rënduar deformimi dhe shkatërrimi.

Epo, kambanat ka kohë që bien! Por, "kjo e rënë" s'është e thjeshtë. Me gjuhën nuk bëhet shaka, sepse pa këtë mjet shprehës dhe të shkruar, s'kemi ku vërnë...! Edhe nëse jemi diku tjetër, pra në toka dhe vende të huaja, ia vlen të tregojmë përmes gjuhës se jemi – ata që jemi. Plus faktit që gjuha shqipe nuk është një "zonjë e përdalë": ajo, është një zonjë e renditur mes dhjetë gjuhëve fundamentale njerëzore.



ASGJË SI DIKUR..!

Libri, lexuesi dhe biblioteka, një trinom i diskutueshëm, që ka tipare të ndryshme në kohëra të ndryshme

Alma ZENALLARI

Diskutohet shpesh për rëndësinë dhe mundësinë e leximit të librit, përparësinë dhe frekuentimin sa më të shpeshtë të bibliotekave nga lexuesit e çdo grupmoshe sidomos të rinjtë. Kjo me qëllimin e mirë që lexuesit të mos i largohen leximit aktiv aq të domosdoshëm, si të librit letrar psikologjik, historik etj., ashtu dhe atij shkencor. Mundësia më e mirë për ta gjetur librin fizik, është biblioteka, sidomos për ata që nuk kanë mundësi ta blejnë e ta bëjnë pjesë të bibliotekave personale.

E pra biblioteka për këdo, krijon mundësinë dhe komoditetin e krijimit të një marrëdhënie të fortë me librin. "Të kesh një kopsht dhe një bibliotekë, ke një pasuri të tërë", do të citonte Ciceroni, sepse biblioteka është dhe mbetet tempull i dijes dhe i kulturës në të gjitha kohërat. Biblioteka është vendi që zgjon kureshtjet, fantazitë dhe imagjinatat njerëzore, mbi vende, ngjarje, histori, tradita, pikëpamje etj. Është vendi që krijon mundësinë e njohjes shpirtërore me autorët shqiptarë dhe ata botërorë të çdo epoke. Është vendi që e mirëpret lexuesin në çdo moment, e sidomos atë lexues që di të zgjedh, që pyet, kërkon dhe debaton. Megjithatë parametrat e lexueshmërisë së librit në gjendje fizike ka ndryshuar ashtu siç ka ndryshuar katërçipërisht edhe mendësia e mentaliteti i njerëzve.

Dhe vetiu lindin një sërë pikëpyetjesh... Nëse para disa vitesh kishte një lexueshmëri për t'u pasur zili, po sot ku jemi me leximin e librave? Përse nuk lexohet si dikur? A mos ndoshta është zbehur rëndësia e ekzistencës së bibliotekave? Në bazë të perceptimeve empirike duket se para viteve '90, dashuria për librin

dhe lexueshmëria e tij ka qenë më e lartë. Libri ishte magji, ishte informacion, ishte dije, kulturë, ishte status. Në ato vite kishte një lexues masiv, madje lexonin dhe ata që nuk e donin librin. Gjithkush ishte në gjendje të thoshte diçka për librin, për tematikat, mënyrën rrëfimtare, për ngjarjet e ngjeshura që përcilleshin nëpërmjet librave. Pse? Sepse leximtarët e diskutonin me qejf librin në shoqëritë e përziera dhe kështu në mënyrë mekanike, përmbajtja e librit qarkullonte.

Dikur edhe prindërit që nuk kishin lexuar vet, ata sërish e nxitnin fëmijën e tyre të lexonte, të përparonte që të ishte më i përgatitur më i zoti se ata vet, në jetë. Megjithatë kishte dhe një faktor të fuqishëm në favor të kësaj; ishte përhapja kapilare e librit deri në fshatin më të largët, në çdo njësi shkollore, repart ushtarak, kooperativë bujqësore, në vatrat e kulturës në fshat, në ndërmarrje.

Aty do të kishte patjetër një bibliotekë, që brenda normave e censurës kishte një furnizim periodik të pandalshëm edhe të botimeve të reja. Dhe falë kësaj etjeje, falë një yjesie përkthyesish të shkëlqyer që pati Shqipëria, ne u njohëm me ajkën e letërsisë botërore, veçanërisht asaj ruse. Libri ishte i vetmi luks, që me ekzistencën e vet fizike, na bënte të fluturonim mbi jetën e mërziatshme rutinore të mbyllur pa kontakt në kulturën mbarëbotërore, pra me anë të librit jetohej një realitet paralel që ishte plot me jetë, liri, dashuri. Në kushtet e izolimit total vetëm libri të çonte në shoqëri dhe realitete ëndërore me heronj të spikatur, në shkrimtarë, shkencëtarë, artistë, por edhe në ato realitete me kalorës, mbretër, dukë, kontë, baronë, bejlerë,

papë, kardinalë. Një realitet ekzotik falë vetëm librit. Aty merrje gjithfarë informacioni shkencor të divulguar e kështu libri ishte më shumë se libër, ishte jetë.


Situata ndryshoi shpejt me ndryshimet historike. Këto ndryshime historike sollën më pas edhe revolucionin e madh teknologjik. Dolën dy faktorë të rinj përcaktues të fuqishëm. Liria dhe iniciativa private me logjikën e fitimit, solli përmbytjen e tregut me shumë botime, që lexuesit i ëndërronin, por ana tjetër e errët e medaljes ishte se vërshoi mediokriteti, botime me financime private pa asnjë kriter cilësie e shije artistike. Së dyti hyri fuqishëm konkurenti internet, me lehtësirat e aksesit, me shumëllojshmëritë dhe shpejtësinë, bëri që sidomos rinia të përpihej nga këto risi dhe të largohej nga libri. Sepse nuk ishte më ajo atmosfera e ethshme e izolimit, tani informacione të gjithfarëlojshme qarkullojnë online dhe kurioziteti rinor ngopet dhe kënaqet shpejt dhe pa shumë angazhim.

Por, ka edhe një problem tjetër ku njeriu shoqëria ka një rol e mundësi, libri sot për masën e gjerë është një mall jo i lirë, sepse përditë dalin libra të rinj dhe vetëm një pakicë mundën t'i marrin dhe një pakicë më e vogël kanë dëshirën, por jo mundësinë. Cili është problemi? Problemi është rrjeti i përhapjes dhe sistemi i bibliotekave jo vetëm në qytete, por edhe më imtësisht. Edhe bibliotekat qytetare janë të kufizuara në fonde dhe nuk ndjekin dot dinamikën e botimeve kështu krijohet dhe një pengesë shoqërore. Kështu, libri i mirë nuk vete dot te lexuesi, madje në mënyrë okulte ka një lloj dekurajimi për sistemin bibliotekar nga botuesit privatë,

që duan të shesin produktet e tyre e jo të kënaqin lexuesit, dhe këta insistojnë që librat e tyre të bëhen me patjetër pjesë e bibliotekave, por këtu rolin përgjegjës e ka politika shtetërore.

Problem tjetër është dehja nga liria ku çdo kush ka dëshirë të shkruajë e të botojë pa asnjë kufi profesional, dhe kjo lloj letërsie mbufat kanalet e qarkullimit të librit duke krijuar një inflacion mbyttës, duke prishur shijen e lexuesit me mediokritete prej shkarravinash. E këtapseudokrijues mediokër, që kanë dhe ndonjë lekë, me reklama dhe me promovime pompoze, me financime private bëjnë që të mos duket letërsia e mirë e me cilësi.

Sidoqoftë, konkurrenca me teknologjinë do të kapërcehet ashtu siç ndodhi me pikurën dhe fotografinë, me kinemanë dhe ekranin e vogël të televizorit, gazetën me radion etj, që u zhvilluan si alternativa funksionale paralele. E rëndësishme mbetet gjithashtu edhe lehtësimi shtetëror me anë të bibliotekave, sistemit tatimor e doganor për letrën, bojën e aksesorë të tjerë të botimeve. Por, libri është shpikja më e madhe gjeniale e njeriut në misionin e tij të vazhdimësisë së eksperiencës së dijeve dhe artit. Dhe ndonëse ka lëkundje momentale, libri, ky instrument magjik madhështor gjenial, është i pazëvendësueshëm, është garant i civilizimit, i përparimit dhe prosperitetit universal...Libri ka qenë dhe do të mbetet pika më e rëndësishme, falë tij njeriu përsosi vetveten, përsosi komunikimin e tij me botën. Yzedin Hima, shkrimtar e publicist do të thotë: "Libri është dalta me të cilin gdhendim çdo ditë tek vetja, njeriun".



Intervistë: Gersa Rrudha, studiuese

NDËRTIMI I URAVE, ZANATI MË FISNIK I NJERIUT

Letërsia të jep shijen dhe bukurinë estetike dhe shpirtërore, kurse filozofia është i vetmi instrument i sigurt i formimit më të shëndoshë mendor, për të cilin ka aq shumë nevojë realiteti shqiptar



Intervistoi: Shkëlzen HALIMI

Gersa Rrudha është një emër që premtton shumë dhe që është duke depërtuar me hapa të sigurt në letrat shqipe. Ajo është lindur në 1 shkurt 1999, në Lushnjë. Në vitin 2021 është diplomuar me rezultat të shkëlqyeshëm në Universitetin e Bukureshtit për filologji në gjuhë të huaj, gjermane dhe angleze. Aktualisht vazhdon studimet e masterit për "Strategji komunikacionale interkulturore-letrare dhe linguistike gjermane". Ajo veç fushës së studimeve letrare e filozofike, është fokusuar edhe në fushën e përkthimeve. Gersa është një ambasadore e vlerave më të mira ndërkulturore, në përpjekjen misionare të zhvillimit të marrëdhënieve midis popujve tanë miq, Shqipëri- Rumani. Dhe jo vetëm kaq...

Cila është Gersa Rrudha?

-Jam vajzë e një familje fisnike lushnjarësh. Letërsinë e kam dashuruar që e vogël dhe kam nisur të

shkruaj që në bankat e shkollës së mesme, por studimet në Katedrën e gjuhës dhe letërsisë së huaj në Universitetin e Bukureshtit më rrënjosën edhe dëshirën që t'i futesha botës studimore të autorëve, studiuesve dhe filozofëve për të cilët mësoja. Po kështu, formimi i spikatur filologjik e sollti të natyrshëm kalimin në fushën e përkthimeve, duke më bërë kështu të fokusohem kryesisht në drejtimin filozofik dhe në zhanrin e letërsisë filozofike. Gjuhësia, letërsia dhe filozofia besoj se janë shtyllat e angazhimit tim të tashëm dhe të ardhshëm si filologe, studiuese dhe përkthyes.

Edhe pse e re, ju keni botuar tashmë, në një vëllim dy-gjuhësh, studimin letraro-filozofik me titull "Vreshti i Shopenhauerit në mushtin e valleve të Lasgush Poradecit", i cili ishte vazhdim i temës së diplomës së mbrojtur në gjermanisht dhe të vlerësuar shkëlqyeshëm në Universitetin e Bukureshtit. Cila është tema kryesore që ju trajtoni dhe pse ky titull?

-Pyetja kryesore e punimit tim është nëse filozofia natyrore e filozofit të madh gjerman, Shopenhauer, ka arritur të ndikojë në poetikën e poetit shqiptar Poradeci dhe nëse po, në çfarë mase dhe i cilit lloj ka qenë ky ndikim?! Duke perifrashuar një citim nga vepra më e famshme e filozofit, "Bota si vullnet dhe si përfaqësim", teza kryesore kërkon të provojë që "mushti ose vera magjike e poetikës së Poradecit, si një burim i rëndësishëm mes burimeve të tjera të formimit të tij, u kultivua dhe prodhuan nga vreshti i mendimeve të Shopenhauerit mbi thelbin e artit, gjenit dhe metafizikës, filozofinë natyrore, të shoqëruara këto me themelin e doktrinës së tij të botës. Pas pohimit të kësaj valence të llojit të parë, atë të filozofisë së natyrës së "Botës" shopenhaueriane, në mënyre diakronike, pra, në të gjitha grupet tematike ku mund të ndahet poezia e autorit, mund të pohohet edhe valenca e dytë e rëndësishme e ndikimit të filozofit, ajo e përfaqësimit estetik të botës, si formë e re e shprehjes artis-

tike që ka lidhje me theksin të estetikës e poezisë dhe thelbit të artit që parashtrohet Shopenhaueri gjerësisht në suplementet e veprës së tij, të trajtuara për herë të parë dhe të pabotuara ende në shqip.

Cila është metoda e hulumtimit që keni përdorur për të ekzaminuar korpusin letrar të veprave lasgushiane dhe në ç'përfundime keni arritur?

-Teza ime është e ndarë në tre pjesë. Në pjesën e parë trajtoj raportin e filozofisë së Shopenhauerit me ambientin shqiptar, në lëmin e mendimit dhe letërsisë, duke përdorur kryesisht metodën e reception history. Pjesa e dytë e punës sime, që mund të përmbledhet në perifrashimin e madh "Mikrokozmos", shqyrton raportin filozofik e Shopenhauerit/korpusi i veprës së Lasgush Poradecit, bazuar kryesisht në metodën hermeneutike dhe në atë të raportimit dhe interpretimit të tekstit. Kështu, nëpërmjet një përzgjedhje citimesh dhe parimesh nga Shopenhaueri, si prizëm studimor, dhe nëpërmjet ilustrimesh të përzgjedhura nga poezitë e Lasgushit, për shembull, në poezitë e natyrës dhe liqenit arrij në përfundimin se ato frymëzohen vërtet nga filozofia e natyrës së Shopenhauerit, por nëpërmjet interpretimit të tekstit, Poradeci aty arrin edhe në një anima mundi krejtësisht personale, që ka si pikënisje mjaft elementë të përbashkët me konceptimin që Shopenhaueri mendon se poeti është mbartësi i idesë së njerëzimit. Pjesa e tretë, që mund të përmbledhet në perifrashimin "Makrokozmos" shqyrton raportin filozofik e Shopenhauerit/jetës, ambienti personal ku u rrit, u formua dhe zhvilloi jetën e vet private dhe artistike autori, bazuar kryesisht në një gërshetim të këtyre dy metodave të përmendura më sipër. Nëpërmjet një ilustrimi të nocioneve dhe koncepteve të Shopenhauerit për gjenin, për asketizmin dhe etikën transcendentale kam gjetur mjaft paralele dhe ngjashmëri mes tyre dhe rrëfimet autobiografike prej miqve, shokëve dhe fëmijëve të autorit për jetën, formimin dhe mënyrën e ushtrimit të poetit.

Ky libër është quajtur nga kritika si një risi në studimet lasgushiane. Pse Shopenhauer dhe Poradeci? Cilët janë argumentet kryesore që e bëjnë atë të ndryshëm nga gjithë kritika qindvjeçare e veprës së Lasgushit?

-Në fillim doktrinën e Shopenhauerit e kam përmbledhur në një prizëm konceptesh themelore të filozofisë. Pastaj, përgjatë studimit tim, është arritur të trajtohet dhe të ilustruhet në



një masë të konsiderueshme, i gjithë ndikimi i saj në të katër grupimet më të mëdha, në të cilat mund të ndahet poetika e Poradecit. Pikërisht prerja diakronike dhe në poezitë më përfaqësuese të çdo grupi, dhe jo në mënyrë rastësore nga njëra anë, dhe përputhja jo e koncepteve dytësore, por atyre me kryesoret të doktrinës së filozofit nga ana tjetër, është demonstrimi kryesor i vërtetësisë së tezës. Gjithashtu, profili i formimit në shkollë dhe universitet, i formimit letrar e artistik përgjatë jetës, i forma mentis të studiuar të autorit dhe qëndrimit përgjatë jetës dhe zakoneve më të spikatura të poetit, përputhet shumë me filozofinë dhe doktrinën e Shopenhauerit, të jetës dhe vdekjes, nga njëra anë dhe të kulturës e disiplinës gjermane nga ana tjetër, simbolizuar parësisht në idhullin e tij për veprën e Gëtes, e plotëson parimin se botëkuptimi në mikrokozmosin e krijimit dhe formimit poetik dhe në makrokozmosin e jetës së Poradecit, është i ndikuar shumë nga Shopenhaueri dhe kultura gjermane. Edhe teoria Shopenhauerit për artin, kryesisht në parimin e rëndësishëm të përfaqësimit estetik të botës, si një formë e re e shprehjes artistike që ka të bëjë me theksimin e estetikës së poezisë dhe thelbit të artit, gjen mjaft analogji dhe paralelizma në artin magjik të Lasgushit që e ka lartë vlerën estetike.

Po kaq befasues për moshën e re është edhe një tjetër botimi juaj, përkthimi i njëres prej kryeveprave të Hegelit, "Shkencës së tij të logjikës"? Cilat kanë qenë vështirësitë kryesore të këtij përkthimi?

Përkthimi në vetvete është i vështirë, sepse përkthimi i vërtetë i reziston kohës dhe nuk është gjë tjetër

veçse ribërja e letërsisë me dashuri e përkushtim në gjuhën e lexuesit, për të cilin ajo përkthehet. Letërsia, filozofia apo çfarëdo forme tjetër arti në gjuhë të huaj, duhet të përsërisë suksesin në gjuhën origjinale. Me këto kritere, përkthimi është një mision i cili kërkon një disiplinë që duhet respektuar dhe trajtuar me kujdes, po njëjloj në formimin filozofik të përkthyesit, ashtu dhe në aftësitë e tij filologjike, që shkojnë përtej njohjes shumë të mirë të gjuhës. Prija ime e përgjithshme ndaj filozofisë dhe veçanërisht ato të nevojshme për të hulumtuar sa më thellë dhe gjerësisht doktrinën e Shopenhauerit, përgjatë vitit kur pata mundësinë të trajtoja subjektin e temës sime të diplomës, që më vonë solli librin tim të parë kërkimor, m'i forcoi mjaftueshëm njohuritë dhe pjekurinë filozofike, për të kaluar edhe te një autor që është i lidhur ngushtë me të, edhe pse në kahun e kundërt. Filozofia e Shopenhauerit shquhet si anti-hegeliane. Për këtë arsye, meqë qe dhe e pabotuar ndonjëherë në shqip, ia propozova Shtëpisë botuese "Plejad" që kishte botuar edhe Shopenhauerin në shqip nga po i njëjti botim dygjuhësh (gjermanisht-italisht), edhe projektin e veprës kryesore të Hegelit "Enciklopedia e shkencave filozofike". Kjo enciklopedi përbëhet nga tri vepra që mund të qëndrojnë shumë mirë edhe më vete. Bashkë me ta përzgjedhëm këtë vepër, jo vetëm për vlerën, por edhe si pikënisje në shkallën e vështirësisë që paraqisnin dy pjesët e tjera. Filluam me "Logjikën" e do vazhdojmë me pjesën tjetër, "Filozofia e shpirtit". Për ta rritur cilësinë e përkthimit konsultova gjerësisht botimin dy-gjuhësh që është goxha shpjegues dhe me aparat ndihmues. Kurse për terminologjinë kam diskutuar gjatë me botuesit që

janë të specializuar në këto botime, të cilët më kanë ndihmuar të kapërcej vështirësitë e karakterit historik estetik dhe filozofik. Por kryesorja, në cilësinë e përkthimit të një veprë filozofike ndikon formimi i përshtatshëm i përkthyesit.

Mos vallë kjo ka qenë edhe shtypa për të vazhduar në rrugën e përkthimit, dhe a është e vështirë të marrësh përsipër një mision të tillë?

Ishte kjo prirje e brendshme që gjeti provën e parë të përkthimit i Hegelit, ajo që më drejtoi të vazhdoja më pas me letërsinë rumune, relativisht pak të njohur në Shqipëri. Dëshira për këtë letërsi lindi si pasojë e lidhjes sime të fortë emocionale me Bukureshtin dhe Rumaninë gjatë qëndrimit tim si studente këtu për pesë vite rresht. I detyrohesha moralisht gjuhës rumune të studiuar gjatë këtyre viteve, për të dhënë edhe unë kontributin tim si përkthyes e veprave të një plejade kolosësh të letrave rumune. Ky fakt më motivoi që të përpiqesha t'i bëja të njohur lexuesit shqiptar një vepër të rëndësishme të Mirçea Eliades, shkrimtar ky shumë i njohur me prirje filozofike, një novelë të të cilit, e kam përkthyer kohët e fundit dhe që është gati për botim. Ndërsa në bashkëpunim me «Traduki» kam përfunduar dhe pritet të botohet së shpejti vepra e njohur "Për dy mijë vjet" nga Mihail Sebastian, një shkrimtar ky që botohet për herë të parë në shqip. Përveç kolanës së përkthimeve jam angazhuar edhe në disa studime të tjera në fushën e historisë dhe filologjisë. Si pjesë e stafit të Tricolor.al, një portal i cili ka për qëllim kryesor bashkimin e dashamirësve të Rumanisë në Shqipëri, por edhe anasjelltas, jam munduar të nxjerr në dritë dhe të pasqyroja jo vetëm vlerat tradicionale të bashkëpunimit të dy vendeve mike, por edhe të njihja lexuesin shqiptar me vlerat kulturore dhe shpirtërore arumune, fushat e bashkëpunimit midis Rumanisë dhe Shqipërisë në vazhden e historisë sonë së ndërsjellë, por edhe disa kërkime dhe studime të miat rreth çështjes së arumunëve, me tema të tilla si: "Dora d'Istria midis Lindjes dhe Perëndimit", "Voskopojat: qendra më e zhvilluar kulturore e arumunëve dhe shpallësja më e madhe e kulturës në të gjithë Ballkanin", "Naum Veqilharxhi dhe rugëtimi i shqipes në epokën e Lindjes së kombeve", etj. Në tërësinë e kësaj veprimtarie, jam munduar të promovoj në çdo hap timin, idenë e ndërtimit të një ure profesionale, kulturore dhe akademike midis Shqipërisë dhe Rumanisë, si një ambasadore e vlerave më të mira ndërkulturore, në përpjekjen misionare të zhvillimit të marrëdhënieve midis popujve tanë miq.

Çfarë prioritetesh i keni vënë vetes në vijim, cilat janë disa nga projektet tuaja në të ardhmen e afërt në fushën e krijimtarisë dhe të studimeve?

Në punën time për përgatitjen e temës së masterit në filologji, në lidhje me Ndërkulturalitetin albanologjik gjermano-arbëresh nga vitet '800, duke filluar që nga Lajbnizi dhe Nikolle Keta deri te Kamarda dhe Majeri, kam gjetur dhe studiuar thellësisht historinë e zhvillimit të dialekteve të gjuhës shqipe, historinë

e shkollave të para shqipe dhe të alfabetëve të shqipes, e në përgjithësi për raportet e gjuhës shqipe dhe historisë me shkollën albanologjike të arbëreshëve në vitet '800, për të cilat kam shkruar disa artikuj, të cilët i kam paraqitur përjashtimisht për "Hejzën". Ndërkaq, kam nisur edhe një studim të veçantë dhe goxha angazhues nga ana akademike në lidhje me marrëdhëniet e shqipes dhe rumanishtes në kuadrin e studimeve të gjuhësisë ballkanike, për të cilat do të përpiqem të jap edhe disa konsiderata përfundimtare. Por, ajo që do të doja të paraqisja në mënyrë përfundimtare është projekti i një libri me sprovë filozofike me titull "Shpresa filozofike", sprovë këto që po njëjloj kanë gjetur zanafillën e botimit të tyre në faqet e "Hejzës". Në të përmblidhen ide, shqyrtime dhe sugjerime të shkencave filozofike e sociale për themel-hedhjen e një kohe të re të gjithë sistemit-vend shqiptar, një stinë që t'i përgjigjet ndryshimit të kohëve dhe kushteve shoqërore, e që t'i shkojë më shumë përshtati domoshmërisë sonë historike dhe premisave të sotme gjeopolitike, në përputhje me shpirtin dhe evoluimin e ndërgjegjes social-politike të qytetarëve tanë gjatë gjithë këtyre 30 viteve të tranzicionit.

Si e shihni qasjen e të rinjve drejt filozofisë sot. A është një kontakt që po bëhet gjithnjë e më i largët?

-Kam bindjen dhe besimin e plotë se përqendrimi në përkthimet e veprave filozofike, po njëjloj si dhe studimet e klasikëve, do t'i shërbejë shumë të rinjve që studiojnë jo vetëm në degën e filozofisë, por edhe në fushat e tjera të studimit. E shoh si një mundësi të madhe formimi për brezin tonë të ri. Letërsia të jep shijen dhe bukurinë estetike dhe shpirtërore, kurse filozofia është i vetmi instrument i sigurt i formimit më të shëndoshë mendor, për të cilin ka aq shumë nevojë realiteti shqiptar. Formimi im jashtë Shqipërisë ma ka diktuar një gjë të tillë. Në këtë këndvështrim shkolla jonë është krejtësisht e paplotë dhe e papërgatitur për këtë prioritet. Por, unë kam besim se të rinjtë shqiptarë kanë dëshirën e mirë të studiojnë e po ecin përpara drejt të ardhmes për të ndriçuar mendjet e tyre, duke lexuar vepra të një kalibri të tillë. Filozofia duhet të vihet në qendër të vëmendjes së gjithë strukturës sonë kurrikulare...jo të hiqet prej saj. Ideja e botimit të klasikëve pajtohet pikërisht me këtë prioritet. Që të shtrojmë edhe një problem të madh edhe demokratik. Formimi filozofik ndikon direkt me edukimin demokratik.

Pas përfundimit të studimeve, do të kthehesh në Shqipëri, pasi shumica e të rinjve që studiojnë jashtë dhe kanë arritje të shkëlqyera nuk e gjejnë më veten në atdhe?

-Ky është një trend i dhimbshëm, dëshpërues që duhet të ndryshojë menjëherë. Është e vërtetë që Shqipëria ka shumë problematika në këtë drejtim, por nga ana tjetër nuk mund të mungojë kurrë dëshira për të kontribuar për vendin tënd dhe për njerëzit e tu. Do të doja që edhe në jetën time studimore të ndërtoja një urë midis botës shqiptare dhe asaj jashtë Shqipërisë. Tek e fundit, ndërtimi i urave është zanati më fisnik i njeriut.

ANTOLOGJIA E TREGIMIT BALLKANIK

Vëllimi antologjik përmbledh një numër të madh autorësh, gjithsej 68, 70 tregime dhe marrin pjesë 34 përkthyes, nga dymbëdhjetë shtete të Ballkanit

Stavri J. DAJO, Selanik


Kohë më parë në Greqi, nga shtëpia botuese Literatus (Selanik), u botua "Antologjia e prozës tregimtare ballkanike", e cila u prit me lavde nga kritika dhe lexuesi. Antologjia përmbledh një numër të madh krijimesh në prozën e shkurtër dhe është fryt i një pune të gjatë bashkëpunuese të shtëpisë botuese me universitetet më të njohura të shteteve pjesëmarrëse ballkanike. Por, deri në botimin e saj duhet të kapërceheshin shumë pengesa, paragjykime dhe vështirësi.

Padyshim, proza e shkurtër rrëfimore (tregimi) e gadishullit ballkanik, edhe pse ndër më të begatat në botë, është, megjithatë pak e njohur, madje dhe për vetë popujt e Ballkanit. Shkaku kryesor i padijes –dhe shumë herë i neverisë së ndërsjellë– ishte ndoshta skepticizmi i rrënjësor i popujve ballkanikë ndaj njëri-tjetrit, shtetet e të cilëve u formuan në një periudhë vizioni të shfrenuar të irredentist, pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, në të cilën ata kishin bashkëjetuar në regjimin e "prehrut të hekurt" të Portës së Lartë përreth gjysmë mijëvjeçari. Dhe vetëm ky fakt presupozonte gjëllimin e një letërsie që kultivonte mëri të pashuar, keqdashje dhe urrejtje ndaj popullit fqinj dhe vlerave të tij intelektuale. Më pastaj, popujt ballkanikë u përfshinë në konflikte ushtarake dhe përlëshje të përgjakshme për një rrip toke, për një thepajë ose kacafyteshin se kush kishte autorësinë e vlerave të kulturës dhe të artit, të cilat kishin lindur nga një nënshtrat i përbashkët për shekuj me radhë, të rrekur në mëdyshje boshe dhe të dyshimta "shkencore" dhe alternativa shantazhuese e kërcënuese. Dhe diversiteti gjuhësor ballkanik –i kthyer nga bekim në anatemi– nuk ndihmoi veçanërisht në ndërveprimin shpirtëror dhe intelektual, në një kohë që vëmendja akademike ishte përqendruar në mënyrë blasfemuese se kush është autokton dhe kush është i huaj në gadishull, kush kishte epërsinë intelektuale të dijës dhe të kulturës dhe kush duhet të pranonte inferioritetin ndaj tjetrit. Kësisoj, ky komunikim agravonte më shumë në një lloj shpifje të kamufuar se sa në një përpjekje të mirëfilltë shkencore në kërkim të së vërtetës dhe në të mirë të dijës.

Një dëshmi e meskinitetit të pashpëjeguar ballkanik është fakti se për shumë vjet njohja e shkrimtarëve ballkanas dhe e veprës së tyre bëhej me ndërmytesimin e metropoleve kulturore, të Parisit dhe francezëve, të Londrës dhe anglezëve, apo të Moskës dhe të rusëve etj., edhe pse kultura shpirtërore ballkanike buron nga i njëjti substrat indo-evropian. Këtë e dëshmon, ndër të tjera, kryqëzimi dhe riprodhimi i dukshëm i letërsisë popullore ballkanike (krijimtarisë gojore), veçanërisht i baladave, të cilat u bënë shkak për "zënka të pafundme shkencore" se kush kishte venomin e arketitipit (autorësisë) dhe kush të imitacionit (ose derivatit), duke dhunuar

ΣΤΑΥΡΟΣ Γ. ΝΤΑΓΙΟΣ

ΑΝΘΟΛΟΓΙΑ ΤΗΣ ΒΑΛΚΑΝΙΚΗΣ ΔΙΗΓΗΜΑΤΟΓΡΑΦΙΑΣ



LITERATUS | ΛΟΓΟΤΕΧΝΙΑ

parimet shkencore për qëllime nacionaliste. Kjo vazhdoi për dhjetëvjeçarë, derisa një gjuhëtar i urtë, Roman Jakobson, duke dashur t'i japë fund tensionit intelektual shterp ballkanik, vuri në dukje se letërsia dhe gjuha popullore lindin falë një procesi të ngjashëm dhe të mundimshëm konceptimi të ngadaltë. Prandaj, vështirë se mund të llogaritet mosha e tyre e saktë. Por përsëri, as ky trajtim radikal shkencor nuk e qetësoi ndërgjegjen ideologjike dhe estetike të studiuesve të Ballkanit, angazhimi akademik i të cilëve mbetej syhapët ndaj çështjeve të vetëdijës historike dhe të ndërgjegjes nacionale(iste). Asnjëherë nuk mund të jesh i sigurt nëse areali ballkanik hoqi njëherë e mirë qafe ngarkesën toksike nacionaliste dhe pasionet përçarëse të së shkuarës.

Për pasojë, hartimi i një vëllimi antologjik i pasurisë tregimtare ballkanike, i lavdërueshëm si synim, nuk është aspak një punë e lehtë. Infrastruktura ekzistuese bibliografike është e pakët dhe deficitare. Megjithatë, edhe ato pak përmbledhje antologjike dhe librat me tregime të autorëve të veçantë ballkanas që kemi zgjedhur shquhen

për cilësinë dhe profesionalizmin e tyre. Duke mirëkuptuar vështirësitë e kohës kur janë botuar, të gjithë këta antologë me emër, meritojnë vlerësimin tonë të sinqertë. Antologjitë e tyre ishin orientimi ynë bazë për autorë, vepra dhe tematikë.

Megjithatë, vështirësitë në përzgjedhjen dhe hartimin e një përmbledhjeje me tregime bashkëkohore ballkanike mbeten të shumta dhe të ndërlikuara dhe në shumicën e tyre të njohura: publiciteti i pakët i veprës së shkrimtarëve jashtë kufijve të atdheut-mëmë dhe aq më shumë përkthimi tejet i kufizuar i tregimtarisë në gjuhë të huaja, kualifikimi i veprave të njohura të shumë autorëve ballkanas si bartëse të koncepteve nacionaliste –sëmundje shpirtërore e përsëritur dhe e përhershme në Ballkan– vlerësimi dhe përzgjedhja e saktë e shkrimtarëve që jetuan nën tutelën komuniste (të të gjitha vendeve, pos Greqisë dhe Turqisë), dhe glorifikimi i regjimeve totalitare etj. Një nga vështirësitë e paparashikuara në përzgjedhjen dhe përkthimin e materialit të antologjisë, ishin prozatorët e vendeve të ish-Jugosllavisë, të cilët edhe pse bashkëjetuan në

mënyrë harmonike përgjatë pesëdhjetë viteve të sundimit komunist, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, termi "shkrimtar jugosllav", siç e kishim njohur, u suprimua dhe u zëvendësua, për shembull, me boshnjak për Ivo Andriçin, të cilin serbët e konsiderojnë, megjithatë, si shkrimtar të tyre kombëtar etj. Këta shkrimtarë duhej të gjenin tani strehën e tyre kombëtare se termi "letërsi jugosllave" pushoi së qeni.

Pas ndryshimeve kozmogonike të viteve '90, shpërbërja e bllokut lindor dhe degradimi gjithëpërfshirës i Jugosllavisë Federale, nga e cila lindën vende të reja, letërsi të reja dhe seksione të reja gjuhësh ose dialektesh, antropogjeografia, rindërtimi territorial, rishpërndarja intelektuale ndryshoi në mënyrë drastike dhe peizazhin letrar-estetik të rajonit. Dolën në pah nevoja të reja dhe u vendosën kritere të reja për t'iu përgjigjur shpërndarjes bashkëkohore etnologjike, shtetërore dhe gjuhësore në Ballkan. Ky, në anën tjetër, përbën një shembull tregues që Ballkani mbetet një gjenerues i pashtershëm shpirtëror dhe mund të formojë fare mirë një zonë letrare Schengen të Ballkanit; një koncept ballkanik për njerëzit e saj të begatë në shpirt, në kundërvënje me trajtimet shpeshherë arrogante të Evropës metropolitane. Letërsia e tij nuk është aspak inferiore kundrejt prodhimit letrar botëror evropiano-perendimor-centrist.

Vëllimi antologjik përmbledh një numër të madh autorësh, gjithsej 68, 70 tregime dhe marrin pjesë 34 përkthyes, nga dymbëdhjetë shtete të Ballkanit, të cilët janë evidentuar dhe dalluar në ndërgjegjen e shkencës kritike studimore dhe sidomos në ndërgjegjen shpirtërore të lexuesit nga botime të mëparshme. Kësisoj, një pjesë e tregimeve janë përzgjedhje nga botimet e vjetra, ndërsa ka shumë përkthime të reja nga letërsia e shquar bashkëkohore e prozës tregimtare ballkanike.

Në përzgjedhjen –e autorëve dhe krijimeve– ndihmuan ekspertë nga të gjitha vendet e Ballkanit, të cilët i falënderojmë sinqerisht, pa përjashtuar megjithatë subjektivitetin se me këtë kemi prezumimin e saktësisë shkencore të pagabuar. Tek e fundit, saktësia në përzgjedhjen e materialit të tregimit të shkurtër dhe të autorëve të një botimi antologjik është një utopi. Asnjë antologji nuk pretendon kredencialet e përfaqësimit të pagabueshëm dhe nuk i atribuohet modeli i vlerave dalluese estetike më të mira të letërsive kombëtare; ajo thjesht sugjeron ekzistencën e tyre. Asnjë antologji nuk është një hartë e përplotë letërsisë.

Për sa i përket strukturimit përmbajtësor, ky vëllim antologjik mbulon të gjithë harkun kohor të shekujve të 20-të dhe 21-të, është i thjeshtë, pa informacion të panevojshëm shkencor apo të dhëna biografike të autorëve të antologjizuar; informacion të tillë lexuesi mund të vjelë nga shumë burime, tek të cilat ai tani ka akses të shumanshëm nëpërmjet linkëve të shumta.

FYELLI i Naim Frashërit si aluzion i njeriut të plotë

DRITA NË ARKAT SHPIRTËRORE

Tingulli i fyellit është zjarr dhe i njëjti zjarr kalon edhe tek ata që e dëgjojnë, sodisin. Emocionet që ngjall janë djegëse dhe mbresëlënëse. A është e mundur të dëgjosh fyellin dhe të mos digjesh?

Metin IZETI

(Vijon prej numrit të kaluar)

Fyelli, respektivisht, njeriu i plotë (insan kamil) flet për sekretin e origjinës. Ai është i afërt me njerëzit e mirë dhe të ligë brenda popullatës së gjerë dhe sillet mirë me ta. Pasi njeriu në çdo gjendje të tij prezantohet në rrugën e arritjes deri te e Vërteta. Pikërisht për këtë, njerëzit në suaza të diturive dhe ndjesive të tyre, afrohen me këta njerëz të ngritur dhe përpigjen të përjetojnë gjendjet e tyre.

*Njerëzit me mua rrinë,
Unë qan' e mallëngjehem,
Po dufn' e pshehtës'm'a dinë
Andaj kurrë s'përdëllehem.
Gjith' ata që janë ndarë
Fyellit shokë ju bënë,
Shkallët' e tij disa farë,
Na shkalluan mëndjen tënë.*

DERI TE TË VËRTETAT

Unë njerëzve të secilës shkallë ua tregova sekretet e realitetit, mirëpo ata m'u afroan në bazë të mendimeve të tyre. Nuk e kërkuan rrugën e arritjes deri te njohja dhe qëllimi i sekreteve të mia të brendshme. Por, për të ecur në rrugën e të ngriturve, duhet lëshuar rrugën e spekulimit. Shkurtë, e vërteta hyjnore nuk dihet me spekulim. Deri te të vërtetat arrihet vetëm nëpërmjet të dijes bindëse (jakin), duke lënë prapa çdo lloj të dyshimit dhe dy mendësisë. Vetëm nëpërmjet të kësaj rruge ka mundësi të shihet drita në arkat shpirtërore dhe kuptimi i varrosur në fjalët e evliave.

*Rrëmet i njerëzisë!
Zër' i fyellit s'është' erë,
Ky është' zjarr' i dashurisë
Që i ra kallamit mjerë!
I ra qiellit e ndriti,
I ra zëmrësë e nxehi,
I ra verës e buçiti,
I ra shpirtit, dhe e dehu.
I dha erë trëndafilin
I dha dritë bukurisë,
I dha këngëtë bilbilin,
I dha shije gjithësisë.
Ayzjar i ra në qiej,
Edhe duke përvëluar,
U bënë kaq yj e diej,
Që i mba Zoti ndër duar,
Nga ky zjar' Zot' i vërtetë,
Që ka ngehur gjithësinë,
Hoti një shkëndijë në jetë,
Dhe bëri soje njerinë.*

Njeriu pasi të kryejë udhëtimin gjysmëharkor të zbritjes së substancës hyjnore dhe të kalohet shkallët e zjarrit, ajrit, dheut, bimës, kafshës e fillon gjysmëharkun e ngritjes drejtë Zotit dhe në hapin e parë të kësaj ngritjeje e përjeton qenësinë. Njeriu është pasqyrimi substancës hyjnore në këtë pikë.

Kur të arrijë në këtë pikë, për t'u kthyer drejtë origjinës ka dy rrugë: Nëse e mbaron jetën dhe vdes pa u ngritur. Por, në këtë mënyrë ai nuk fiton asgjë prej kalimit të jetës. Ai gjatë jetës së tij në këtë botë nuk e ka ditur se kush është, prandaj edhe në botën tjetër do të jetë në gjendje të paditurisë.

Ndërsa nëse njeriu në këtë botë takohet me një njeri të ngritur, gjegjësisht nëse e dikton substancën e tij me kujdesine një udhërrëfyese, ka mundësi të kuptojë se për ku dhe kë e ka përmallimin në brendinë e tij. Së pari e gjen Zotin në botën e tij të brendshme e

më pas në atë të jashtmen. Të ndierit e ekzistencës së Zotit në brendinë njerëzore emërtohet si "texhelli" (pasqyrim). Njeriu që ka arritur të përjetojë pasqyrimin hyjnor, gjithësinë e vështron me vështrimin e Zotit dhe bëhet pronar i sekretit me të cilin e sheh Zotin në çdo vend. Kjo gjendje, është ripërtëritje e dijes me Zotin. Por, nuk është takim (visal) i plotë. Njeriu edhe kur të arrijë në shkallën e përsosmërisë ndien një përmallim të shijshëm për origjinën e tij.

Frymat e ngrohta dashurore kalon në brendinë e fyellit. Kjo frymë, lëvtron dhe nxjerr çdo gjë përveç dashurisë prej tij, prej njeriut. Pastaj e sjell në pozitë buzë më buzë me të dashurin. Fillon të rënkojë dhe të vajtojë. Rënkimi dhe vaji që vinë prej brenda, njëkohësisht e shprehin edhe

Njeriu është krijuar nga brumi i dashurisë, në çdo grimcë të tij ka gjurmë dashurie dhe mëshire. Ka shenja të mëshirës dhe dashurisë së Krijuesit ndaj robërve të Tij. Njeriu i është dhënë dhurata të dashurojë dhe të dashurohet. Dashuria është uji i mbetur në të çarën e hollë të një shkëmbi që ngrin në dimër dhe e plas, e copëton, e lëshon nga shkëmbinjtë poshtë. Dashuria është një anije që lundron nëpër një uragan. Dashuria është rihapja e luleve çdo pranverë. Dashuria është historia mijëravjeçare e rrapit të madh. Dashuria është rrotullimi i botës. Dashuria digjet dhe nxeh si dielli. Dashuria është ana e bardhë e hënës. Tingulli në fyell, është gjithashtu dashuri; edhe dehja kuptimore po ashtu. Njeriu i dashuruar në Krijuesin e humb veten në bashkësinë me Të. Rrushi është i ëmbëlsuar me dashuri.

konsiderueshme për zgjimin shpirtëror. Qëllimi i këtij "zgjimi" është që t'i mundësojë njeriut "të rikarikojë bateritë e tij shpirtërore", për të rivedosur ekuilibrin e tij mendor dhe shpirtëror.

Këto iluminime në poezinë e Naimit na lejojnë të kuptojmë më mirë botën përreth nesh, të ndjejmë ndërlidhjen midis të brendshmes dhe të jashtmes. Dhe ato gjëra që deri atëherë na dukeshin si të pazakonshme gradualisht kthehen në të zakonshme. Nga njëra anë, bota bëhet më e thjeshtë, dhe nga ana tjetër, më e pasqyrueshme por e përjetueshme, sepse një pjesë e konsiderueshme e të kuptuarit të fituar është shumë e vështirë të shprehet me fjalë.

Në poezinë e Naimit, bukuria fizike konsiderohet si pasqyrim i bukurisë shpirtërore. Prandaj, ai, ngjashëm si edhe shumë poetë sufik, thekson rregullisht bukurinë e jashtëzakonshme të të Dashurit të tij dhe i kushton shumë vëmendje përshkrimit të tij. Ky ideal i bukurisë nuk është as subjektiv dhe as pasqyrim i personalitetit të poetit, shijes së tij, por është një model i vendosur me anë të të cilit poetët portretizojnë karakteristikat e të Dashurit absolut (Zotit). Karakteristikat fizike më së shpeshti krahasohen me motive nga bota bimore, veçanërisht me lule. Bimët janë një motiv shumë i rëndësishëm i kësaj poetike. Trëndafilat, tulipanët dhe zymbylët dhe të ngjashme paraqesin pasqyrimet të koncepteve të ndryshme metafizike. Për shkak të përdorimit të shpeshtë të motiveve bimore, hapësira e dashurisë shpirtërore shpesh krahasohet me një kopsht plot me lule të ndryshme, gjë që thekson se fytyra e të Dashurit është plot me tipare të bukura fizike.

Ndër motivet tjera nga natyra, Naimi ka përdorur edhe erën, ajrin, ujin, dielli, hënën, zjarri, drita. Motivi i erës dhe i fladit të mëngjesit më së shpeshti simbolizon frymën e Zotit, lajmëtarin e lajmit të mirë dhe frymën që jep jetë. Askush nuk troket në derën e të dashurit përveç erës së mëngjesit dhe nuk ka kush të djegë atë në zjarr apo vuajtje. Ai i këndon ndjenjës së mjerimit, duke pohuar se mungesa e të Dashurit (Zotit) sjell vetëm vetminë dhe trishtimin.

Zjarri është një motiv që Naimi e përdor për të përshkruar ndjenjat e dashurisë dhe djegien për Zotin. Ai flet për zjarrin e dashurisë që ndezi zjarrin e shpirtit të tij. Ai zjarr i dashurisë është aq i fortë sa flaka e tij ngrihet deri në qiell. Kjo është një figurë ekzagjerimi, por edhe personifikimi, sepse zemra "digjet dhe rënkton", dhe flaka "ngjitet në qiell". Në këtë mënyrë Naimi ngjall një ndjenjë të fortë vuajtjeje për të rritur ekspresivitetin dhe për ta freskuar shpirtin e tij. Ai i këndon një zemre që digjet nga vetmia dhe malli për të Dashurin. Në vargjet e tij për dashurinë ka aq mall sa flaka e dashurisë ia djeg trupin. Ashiku beson se duke u djegur në zjarrin e dashurisë ai arrin unitetin me të dashurin e tij. Kjo djegie dhe bashkim shpirtëror përfaqësohet nga motivi i një fluturë dhe një qiri, ku i dashuri është një qiri dhe ashiku një flutur që admiron bukurinë e Tij dhe, i tërhequr nga drita, rrotullohet përreth zjarrit. Momenti kur flutura digjet në flakën e një qiriri simbolizon bashkimin shpirtëror të poetit me Zotin.



sekretin e njeriut, gjegjësisht këndojnë për realitetin dhe lumturinë që e përjeton ai në brendi.

ZHDUKJA

Shkurtë, sekretet e fyellit janë shndërruar në fjalë, në gjendje tingullore. Mirëpo, ata që i kanë sytë e mjegulluar dhe që nuk u dëgjojnë veshët, nuk kanë dritë për të pa dhe nuk kanë arritur gjendjen për të kuptuar realitetin për të cilat flet fyelli.

Tingulli i fyellit është zjarr dhe i njëjti zjarr kalon edhe tek ata që e dëgjojnë, sodisin. Emocionet që ngjall janë djegëse dhe mbresëlënëse. A është e mundur të dëgjosh fyellin dhe të mos digjesh? A është e mundur të dëgjosh tingujt e tij të rrënjësura thellë dhe të mos lejosh kujtimet e dhimbshme të vijnë në tru dhe në zemër? A është e mundur të mos kujtojmë dhimbjen e lindjes, dhimbjen e frymës që nxiton në mushkëri? A është e mundur të mos e ndjeni përsëri mundimin në zhvillimin e eshtrave në çdo rritje të trupit? Si mund mos të dëgjojmë ndarjet, poshtërimet, dashuritë, mëkatet...Edhe ne kemi zjarr, zjarri nuk është vetëm tek fyelli. Por ai zjarr herë shuhet, herë bëhet hi. Kjo është zhdukja jonë, rënia jonë në mjerim.

*More zjar' i bekuar!
Unë me ty jam përzierë,
Pa jam tretur e kulluar,
Po të kam shpirt, mos më lerë.*


Procesi i çlirimit nga iluzioni lëndor ia rrit aftësinë e njeriut për të ndjerë. I mundëson të ndjejë dashuri, mirësi dhe dhembshuri, por edhe poshtërim, keqardhje dhe pikëllim. Ai fillon të shohë dallimin midis së drejtës dhe së gabuarës, së mirës dhe së keqes dhe mes asaj që është e hijshme dhe ajo që është e turpshme. Ai e kupton se e mira dhe e keqja nuk mund të krahasohen. Ai zhvillon një shqetësim (ndjenjë detyrimi) për të tjerët. Ai e kupton nevojën për këshilla të mira dhe urdhërim për të mirë dhe ndalim nga e keqja, me fjalë tjera e varros egoizmin dhe egocentrizmin e tij.

ZJARRI

Kërkimi i të vërtetës mbështetet nga dashuria për të vërtetën. Naimi na e kujton nevojën për të dashuruar të vërtetën (hakikatin). Dashuria për të vërtetën manifestohet jo vetëm në një kuptim subjektiv, por edhe në formë transcendentale, si e vërteta apo e Vërteta më e lartë. Dëshira për ta gjetur të vërtetën tregon një kërkesë të

TESTAMENTI BIBLIK I RRESHPJES

Poezia e këtij liriku të madh gjithnjë e më shumë po bëhet e njohur dhe e pëlqyer për lexuesit tanë, pavarësisht përpjekjeve të disa autoriteteve të rrejshme krijuese që provojnë ta përbuzin siç e përbuzën edhe sa ishte gjallë



Bardh FRANGU

Kur flasim për testamentin si formë e shprehjes poetike të krijuesit, kuptojmë se në një mënyrë e gjithë krijimtaria është një lloj testamenti. I tillë është edhe opusi poetik i poetit tonë të jashtëzakonshëm Frederik Rreshpja. Po në këtë refleksion, objekt trajtimi kemi poezinë e tij emblematike "Testamenti", të cilën Anton Nikë Berisha me të drejtë e ka vënë në ballë të librit, përkatësisht përzgjedhjes së poezisë së Rreshpjes me titull metaforik "Era përkund pikëllimin e luleve", botuar nga Shtëpia botuese "Beqir Musliu", në Gjiilan. Berisha në fakt e vë si moto të librit, përkatësisht si një lloj prologu për librin si përzgjedhje e poezisë së Rreshpjes, të cilën e shoqëron me një analizë të gjerë prej 28 faqesh. Sigurisht që në këtë analizë vend të rëndësishëm zë edhe poezia "Testamenti", e cila për shumë arsye meriton analiza nga më të ndryshmet, për më tepër që gjuha poetike e Rreshpjes e mundëson këtë.

Që në vargun e parë të kësaj poezie Rreshpja pohon: "Që fëmijë e kam kuptuar se kisha lindur i mallkuar me art". Kjo dëshmon se Rreshpja besonte se të bërit poezi ishte një dhunti hyjnore. Por, kur e analizojmë poezinë e Rreshpjes në tërësi dhe kur shohim se përmbysjet e situatave të ndryshme jo vetëm si fikcion, por edhe si fakt, janë prodhim i fatit të tij, na bëhet e qartë se deri te kjo pandehmë poeti ka ardhur shkaku që bota tokësore e kishte përbuzur në shkallë absurde, madje duke iu shndërruar në një varr të gjallë. Gjithë këtë e dëshmon me vargjet pasuese: "Gjërat i shihja ndryshe: Njëpër shirat e vdekur". Në kuptimin tokësor shiu simbolizon bereqetin, begatinë, përkatësisht të bukurën utilitare, ndërsa shiu i vdekur në këtë rast shënon përbuzjen tokësore, shënon shpirtin e poetit të mbetur si një tokë, ku bimë e gjallë nuk lëshon rrënjë. Kjo mbase na bën të kuptojmë se Rreshpja që herët i ishte bashkuar poetëve të lirikës moderne evropiane, të cilët për peizazh kishin shpirtat e tyre të zhytur në pellgun e dëshpërimit dhe të vetmisë.

Sigurisht që vargu "Peshqit fluturonin drejt çerdheve, te yjet", është vargu që kërkon një analizë më të zgjeruar, sepse këtu më së miri shohim përballjen e tokësore me hyjnoren. Peshku është simbol shumë i vjetër, madje përmendet edhe te vedat, por dihet se peshku si simbol më domethënës u bë në filltet e krishterimit, kur edhe u bë simbol identifikimi i këtij besimi. Në këtë kuptim, peshqit atdheun e tyre duhej ta kishin në qiell, përkatësisht atje ndër yjet, atje ku edhe shpirti i poetit kishte krijuar universin e tij.

Vargu pasues i kësaj poezie na dëshmon se Rreshpja ishte mjeshtër i ndërtimit të harmonisë absurde: "Në vend të borës binin zogj në çdo dru". Kjo antitezë e bukur para së gjithash dëshmon se Rreshpja ishte një mjeshtër i jashtëzakonshëm i ndërtimit të hapësirës poetike. Poezia vazhdon me një krahasim brilant: "Era si ketër brente degët".

"Qante mbi mua nëna, Shën Mëria ime. Ave nëna ime!" Identifikimi i nënës me të shenjtën Mari është edhe një element më shumë për universin e tij biblik

dhe observimet e tij hipersensibile, të cilat dëshmojnë se sikur Rreshpja është i bindur në atë që besonte G. Bashlar se lart në qiell parajsja është një bibliotekë e madhe. Në këtë mënyrë poeti do të dëshmojë se është vetë Krishti, ngjashëm i gozhuar nga regjimi i kohës së diktaturës dhe i përbuzur edhe pas rënies së saj.

Vargu: "Mos e pastë njeri këtë fat!" na vjen si një klithmë tronditëse e poetit, i cili përpëlitet mes tokës së përbuzur dhe qiellit të pakapshëm, duke ndërtuar kështu një hapësirë poetike, brenda së cilës përplasen jeta dhe vdekja në një dimension krejt absurd.

"Kam dashuruar një Afërditë në Olimpin e trëndafilave", është vargu në vazhdim që nuk nënkupton një bukuri dhe një dashuri të thjeshtë, sepse po ta kundrojmë nga aspekti mitologjik, shohim se Afërdita, e cila personifikon trëndafilat në Olimp, nuk shfaqet këtu vetëm si simbol i bukurisë dhe dashurisë, por edhe si simbol i pafatësisë, ndërsa nuk kishte arritur që në dashuri të kishte lidhje të qëndrueshme. Mbase, këtë e shpjegon më mirë vargu pasues, një si epitaf për fatin e poetit: "Pastaj erdhe ti tërë ikje". Nuk e di a mund të gjejmë një varg më të bukur në letrat tona se ky i Rreshpjes që përkufizon një dashuri të paarritshme, e cila: "Më vonë vije vetëm nëpër ëndrra, si perënditë ilire", do të shprehet Rreshpja, për ta mbyllur fatin e tij jetësor me vargjet: "Kështu iku edhe rinia, filigrani i djalërisë, i mallkuar me art".

Pjesa e fundit e poezisë, e cila na shfaqet në formë epilogu, na dëshmon se Rreshpja, i lodhur dhe i dërrmuar nga jeta në tokë, i ishte kthyer qiellores, përkatësisht hyjnores, por jo si besim, por më shumë si ngushëllim. "Tani që po vdes ëndërroj vetëm një kryq te koka/ dhe të harrohem se nuk dua që edhe pas vdekjes/ të më ndjekë mallkimi i artit/ Mos e pastë njeri këtë fat!". I vetëdijshëm që ishte peng i fjalës së tij, për të cilën u sakrifiku si Krishti, përsëritë urimin që në fakt përbën mallkimin e tij.

"Po kur të vdes portreti im ka për t'u shfaqur/ nëpër gjethe/ se unë kam pasur miqësi me çdo dru". Në këto vargje Rreshpja nuk do të na dëshmojë faktin se njeriu është pjesë organike e natyrës, por faktin tepër dëshpërues se ishte i braktisur nga njerëzit. "Në stinën kur bien gjethet/ do të bien edhe sytë e mi", për ta përmblyllur poezinë me vargjet gjithashtu të mrekullueshme: "Tani e tutje shirat do të jenë lotët e mi/ Mos e pastë njeri këtë fat!"

Duke e analizuar nga këndi i ndërtimit të hapësirës poetike, brenda së cilës vendosen metafora të jashtëzakonshme, nuk kemi si të mos sjellim ndërmend mendimin e Floberit se poezia është si gjeometria. Në këtë rast, pra kur është fjala për Rreshpjen, vlen thënia e Valjdit: "Në vend se poeti të shkruaj poezinë, poezia e shkruan poetin". Dhe krejt në fund duhet të theksojmë se poezia e këtij liriku të madh gjithnjë e më shumë po bëhet e njohur dhe e pëlqyer për lexuesit tanë, pavarësisht përpjekjeve të disa autoriteteve të rrejshme krijuese që provojnë ta përbuzin siç e përbuzën edhe sa ishte gjallë.

RRUGËTIM NËPËR KOHË

(Rreth librave "Andrra në beze" dhe "Korça sipas një kosovari" të Agron Shalës)

Zyrafete SHALA

Stili i të shkruarit dhe qasja origjinale në trajtimin e dukurive të ndryshme të mjedisit tonë, me theks të veçantë të ato kulturore, nuk është e vështirë të dallohen në cilindo shkrim të publicistit Agron Shala. Megjithatë, me dy librat e tij "Andrra në beze" (2018) dhe "Korça sipas një kosovari" (2019), botuar nga Armagedoni, ai tërheq brenda një bote përplot informacione, një bote që mundëson rrugëtimin nëpër kohë, në shoqëri të kryeveprave të artit, nga e cila lexuesi del ndryshe, i transformuar dhe i pasur me njohuri. Jo rastësisht, të dy këta libra janë vlerësuar lart nga njohësit e kulturës dhe letërsisë, por edhe nga lexuesit, të cilët sado që jetojnë në një epokë që karakterizohet me vërshime botimesh nga të gjitha zhanret, prapë se prapë duhet të jenë të vëmendshëm se me çka po e shpenzojnë kohën e tyre.

Libri "Andrra në beze", është përmbledhje me njëzet ese nga kultura, në të cilat, siç sugjeron vetë titulli, pikënisje është analiza e filmit, për të vazhduar më tej me gërmimet e autorit nëpër fushat e tjera të veprimtarisë e dijës njerëzore, fusha këto që pikëtakohen dhe dialogojnë mes tyre. Përmes gërshetimit të zhanreve, Agron Shala arrin të trajtojë një lëndë të gjerë nga fushat e kulturës, filozofisë, psikologjisë, sociologjisë, religjionit e historisë, përmes të cilave i qaset dhe e ndriçon të tanishmen. Ai nxjerr personalitete nga periudha të ndryshme të së kaluarës, të tillë që kanë lanë gjurmë të pashlyeshme, por edhe të tjerë që koha i ka mbuluar me vellon e harresës, i përafrojnë veprat e tyre, i krahason, hedh një dritë të re mbi to, për të nxjerrë pastaj përfundime të vlefshme mbi natyrën e qenies njerëzore dhe mendësisë shqiptare, që sa vjen e bëhet më komplekse.

"Kush vret?" - është pyetja që autori e shtron që në esenë e parë, një pyetje në dukje e thjeshtë, por që kërkon njohje të strukturave të thella të psikës humane. Por, shqetësimi i autorit nuk përfundon këtu, ai shkon përtej kësaj për të arritur te pyetja tjetër edhe më provokuese: "A mund të vrasë artisti?". Pas elaborimit të tezave që ofrohen si përgjigje të mundshme, ku parakalojnë artistë eminentë dhe kundërshtarë të tyre nga shekuj të ndryshëm të historisë, Shala kthehet në aktualitetin shqiptar. Mirëpo, kur arrin në këtë pikë ai nuk përpiqet të zbulojë potencialin vrasës të artistit shqiptar, përkundrazi, ai sugjeron se në mjedisin tonë mediokrit vishen me petkun e artistit për ta vrarë artin vetë... dhe ky përfundim është një përshkrim i dhimbshëm i fatit të krijuesit të ne, që duket se ende nuk mund të çlirohet nga mallkimi: "U bëfsh e mos paç ku me u bo".

Në librin "Andrra në beze" nuk thyhen vetëm kufijtë e zhanreve, thyerja këtu merr përmasa më të mëdha. Në esetë e Agron Shalës, thyhen kufijtë e kohërave, disiplinave, ndasitë mes etnive, dallimet në kultura, madje thyhen edhe kufijtë e rrjedhës lineare të mendimit e të narracionit, që na paraqiten

ndryshe nga siç jemi mësuar t'i gjejmë në shkrime të tjera. Mënyra e rrëfimit është e tillë që shpeshherë krijon përshtypjen e rrjedhës spontane të asociacioneve, por edhe të përafrimit të episodeve që fillimisht dalin të fragmentarizuar, por në fund bashkohen duke krijuar një kolorit impresionues. Me këto veçori "Andrra në beze" shfaqet si një univers unik ku vlerësimi final i çdo problematike bëhet nga këndvështrimi i artit.

Një mënyrë të tillë rrëfimi gjejmë edhe në librin e dytë "Korça sipas një kosovari", ku Korça na shfaqet me tërë madhësinë e një qyteti të lashtë, që sjell në kohën tonë gjurmët e shekujve të largët. Libri, në kontura të përgjithshme është i konceptuar si një udhëpërshkrim, që hapet me nisjen, vazhdon me arritjen në destinacion dhe përmbyllet me kthimin. Mirëpo, ky udhëtim, apo kjo rrugë në dukje e shkurtër, del të jetë jo zakonshme dhe hap pas hapi merr kuptimin e një udhëtimi nëpër kohë dhe nëpër epoka, duke marrë trajtën e një gjurmimi brenda shpirtit krijues kolektiv, jehona e të cilit synon të ringjallë një nga tiparet më të veçanta por edhe më të shpërhytyruara të natyrës sonë, dashurinë ndërnerëzore dhe dashurinë për të bukurën.

I motivuar nga vargu kuptimplotë "E dimë ku po shkojmë/por nuk e dimë se ku ishim", shpalosjen e tablosë së bukur të Korçës autori e fillon qysh nga vendosja e gurthemeleve të saj, për të vazhduar më tej me informacione të shumta rreth zhvillimit ekonomik, planit urbanistik, arkitekturës, objekteve kulturore e historike, zakoneve, personaliteteve të njohura që dolën prej aty dhe mendësinë e banorëve të këtij qyteti, që qysh herët tërhoqi vëmendjen e të huajve, për çka u bë i njohur si "Parisi i Vogël në Lindje", epitete ky që nuk i dihet pikënisja. Mirëpo, për autorin pak rëndësi ka se kush e vlerësoi së pari Korçën me këtë epitet, vetë korçarët apo ndonjë nga personalitetet e rëndësishme të kulturës evropiane që u mahnitën me vlerat e saj. Vëmendjen e tij e tërheq fakti paradoksal, dhe natyrisht i dhimbshëm, që kultura e shtresuar brenda këtij qyteti, nuk arriti të tërheq vëmendjen e qeverive postkomuniste dhe për pasojë Korça mbeti një qytet ku 'varfëria i doli në mbrojtje kulturës'. Është kjo një e vërtetë që më së miri ilustron me një fjalë të urtë korçare: "Siç na dinë, qofshim; siç jemi, mos qofshim".

Duke u ndalur te ngjarjet historike që lanë gjurmët e tyre në këtë qytet, autori arrin t'i shpleks fijet që e endin palimpsestin kulturor të Korçës. Gjatë rrugëtim-it të tij, autori ndalet dhe i mbledh të gjitha veçoritë e këtij qyteti, i vendosato si gurët e një ngrehine dhe krijon një monumentmadhështor të Korçës. Kushdo që e bën këtë udhëtim, në përfundim të tij do të ndihet ndryshe, sepse do të huazojë shumëçka nga historia, kultura, shpirti dhe ëndrrat e korçarëve...

AGRON SHALA



KORÇA SIPAS NJË KOSOVARI

AGRON SHALA



ANDRRA NË BEZE

KORTEZHI I NGRIRË

Biser MEHMETI

Me sytë e vagëlluar e shihja kortezhin e dërrmuar që mërdhihej nga të ftohtët. Derisa prisnin të hapej varri, disa lëshonin ofshama të thella nga pritja e mundimshme. Disa madje pshurrnin afër arkivolit, të cilin e kishin sjellë këtu pa dëshirën e tyre... Shumica prej atyre njerëzve ishin miq të Stasit, me të cilin ishin shoqëruar sa kishte qenë gjallë... Disa Stasin e kishin dashur si vëlla. Tash nga goja nxirrnin një lumë sharjesh banale pse ai s'kishte vdekur verës, po dimrit... Sa njerëz të poshtë, i thashë vetes. Edhe sa ka qenë ai gjallë e kanë fyer prapa shpinës. Kjo nuk u ka mjaftuar, po vazhdojnë ta fyejnë edhe pas vdekjes... Kështu do të veprojnë edhe me mua! Do të më shajnë pse s'kam zgjedhur ditën që atyre u përshatet për të vdekur... Më së miri është të vdes në verë, i thashë vetes... Nuk bën as në verë të vdes! Atëherë do të më shajnë pse bën vapë e madhe dhe dielli u bie në kokë si saç!... Kurdo që të vdes miqtë e mi do të më sjellin te varret e pastaj do të kënaqën duke më sharë... Njerëzit janë të mbushur me urrejtje të paqartë. Nuk dinë çka kërkojnë nga vetvetja as nga të tjerët...

Pritja po bëhej gjithnjë e më torturose. Katër ose më shumë të rinj nuk po arrinin ta hapnin varrin, ngase toka ishte shumë e fortë... Një mendje më thoshte se në këtë të ftohtë do të prisnim edhe tri ditë të tjera derisa të hapej varri... Pas pak m'u bë sikur të gjithë miqtë e Stasin, të cilët gjatë gjithë rrugës e fyenin atë pa mëshirë, ishin larguar pa e varrosur atë, ngase nuk kishin mundur ta duronin të ftohtët që po i ngrinte ngadalë. M'u bë sikur unë i vetëm kisha mbetur që ta varrosja Stasin, me të cilin dikur kisha pasur shoqëri të ngushtë... Një zë tjetër më tha: pse u bërë i marrë e nuk u largove edhe ti me kortezhin!... Fillo-

va të dyshoj sikur me zë të lartë u kam thënë: i urrej njerëzit hipokritë që i duan të gjallët e i shajnë të vdekurit!... Unë kam respekt për njerëzit e vdekur më shumë sesa për njerëzit e gjallë!...

Derisa e shihja arkivolin e Stasit zura ta akuzoj veten pse s'kisha shkuar me kortezhin me të cilin kisha ardhur. Stasi është i vdekur dhe çdo gjë që bëj për të ai nuk do të jetë në gjendje të më falënderoj... Kur të kalojë ky dimër polar, vijmë dhe e varrosim trupin e tij... Derisa vështroja e nuk isha në gjendje t'i thosha vetes çka vështroja, m'u bë sikur kortezhi me të cilin erdha te varret ende qëndronte afër meje... Me një zë që më dridhej u thashë: ju lutem, kur të vdes mos më fyeri sikur e fyet Stasin!... A ju kujtohet kur Stasi ishte i gjallë gjithnjë i thoshte se e doni dhe e respektoni mjaft shumë... Ndoshta edhe ai e ka ditur se e keni gënjer tërë kohën, se nuk e keni dashur me të vërtetë...

Troni, miku im më i ngushtë, i cili qëndronte afër meje dhe gjithnjë zgërdhihej, më tha: pse na akuzon ne për gjëra që edhe vetë i ke bërë! Pse shtresh i ndershëm kur je më i keq se të gjithë ne!... S'mund ta durojmë këtë të ftohtë që po na ngrinë ngadalë e në heshtje!... Derisa mundohesha ta gjeja fillin e mendimeve një zë më tha: pse mundohesh ta gënjeshtrosh vetveten! Ti i pari fillove fyerjet ndaj Stasit pasi dyshove se acari kishte nisur të t'i ngrinte të gjitha gjymtyrët e trupit... Edhe pse mundohesha ta kandisja mendjen, se nuk kisha bërë gjëra kaq të neveritshme, ajo gjithnjë më thoshte me tinguj të kumbueshëm: ti je i pari që fillove ta fyesh Stasin për së vdekuri! Pastaj edhe të tjerët filluan ta fyejnë me zë të lartë... Sikur të mos e kishe fyer ti, ndoshta asnjëri nga kortezhi nuk do ta kishte fryrë. Ti je fajtori kryesor që njerëzit u shfryen ndaj Stasit... O Zot, i thashë vetes, ndoshta vërtet e kam fyer Stasin! Ai

ka qenë miku im më i dashur. Shumë shokë e miq të mi erdhën për hatër timin nëpër këtë kohë të ftohtë për ta varrosur kufomën e tij. Të gjithë filluan të çuditën kur më dëgjuan si e fyeja pa mëshirë Stasin. Disa edhe më kanë fyer edhe mua, po këtë gjë e kanë bërë tinëz meje...

Përsëri desha të largohem nga varri i Stasit, po nuk e di pse nuk arrija ta bëja një gjë të këllë. Një zë i heshtur më tha: ti më shumë ke dëshirë të qëndrosh me të vdekurit sesa me të gjallët! Gjithnjë i ke dashur më shumë të vdekurit sesa të gjallët!... Të vdekurit gjithnjë janë të heshtur dhe kurrë nuk të kundërshtojnë për asgjë, madje as atëherë kur i fyen! Me të gjallët puna është ndryshe. Ata gjithnjë flasin gjëra të neveritshme, madje të kundërshtojnë edhe atëherë kur e thua të vërtetën!... Fillova të dyshoj sikur kishte një kohë të gjatë që shoqërohesh me të vdekurit, tek të cilët gjeja kënaqësi, të cilën nuk arrija ta gjeja me të gjallët. Duke qëndruar një kohë të gjatë në mesin e tyre kisha filluar ta ndjeja veten të vdekur sa dyshoja sikur gjendesha në një skaj të amshimit... Kur e shihja mëngjesin, po edhe mbrëmjen si shfaqeshin mbi hapësirën e varrezave, dëshiroja të largohesha nga të vdekurit e të vazhdoja të jetoja në mesin e të gjallëve. Sa herë dëshiroja ta bëja një gjë të këllë diçka më thoshte se të gjallët gjithnjë më kanë urreyer pse më shumë i doja të vdekurit!... Pastaj më kaplonte dilema nëse më mirë do të ishte të jetoja në mesin e të vdekurve apo në mesin e të gjallëve...

Në atë ambient të mbushur me ftohtësi polare, çdo gjë e gjallë dhe e vdekur i nënshtrohej ligjit të heshtjes absolute. Ajo heshtje e tmerrshme ma hante shpirtin si të ishte një gjarpër i madh. Brenda dhe jashtë varrezave edhe koha ishte ndalur. Për të vdekurit ajo s'kishte kurrfarë rëndësie... Ka

edhe njerëz që jetojnë e koha nuk u hyn fare në punë, më tha vetvetja. Disa çaste jam orvatur sërish t'i këpus vargojt e harresës, po s'kisha fuqi të mjaftueshme për ta bërë një gjë të këllë... Edhe pse dua s'mundem tërë jetën të qëndroj në mesin e të vdekurve, më tha një zë i njohur, i cili më përplasej në kokë tash e një kohë të gjatë. Pas pak i kam thënë atij zëri të qetë: prej lindjes në mesin e të gjallëve s'kam mundur të gjej kënaqësi!... Këtë e gjeta në mesin e të vdekurve!... Për fat të keq ende e ndjej veten të gjallë, andaj më duhet të sillem si i gjallë... E di se rruga për atje është e gjatë dhe e vështirë.

Disa çaste më vonë e gënjeva veten se e dija rrugën që më largonte nga varret, po qëllimisht nuk dëshiroja të largohesha. Ai ambient i heshtur më dukej sikur mbushej me njerëz të vdekur, të cilët dëshironin të më shoqëronin. Nga të gjitha anët frynte një erë e lehtë, e cila sikur ma freskonte fytyrën që më digjej flakë. Më kaploi dyshimi sikur kujtesa, mbi të cilën kishte reshur një shtresë e trashë e pluhurit, po më rikthehej ngadalë. Në atë cast s'kisha dëshirë të kujtoja asgjë që më kishte ndodhur e që s'më kishte ndodhur. S'kisha dëshirë të mendoja për vdekjen e Stasit, i cili s'dihej nga çka kishte vdekur, as pse kishte vdekur në këtë ditë të ftohtë dimri. Sa herë dëgjoja për dikë që vdiste gjithnjë kisha bindje sikur unë isha ai që kisha vdekur, sikur gjendesha në arkivol, sikur disa njerëz më dërgonin te varret, sikur trupin ma mbulonin me dhe...

Në pasqyrën e thyer të mendjes e pashë veten sikur ecja në mesin e një kortezhi të lodhur e të rraskapitur nga rruga e gjatë. Shumica e njerëzve ishin të heshtur. Megjithatë, ata nuk mërzhiteshin fare për njeriun që e kishin varrosur në një vend të shkretë...



**TË MARTUARIT**

të martuarit nuk flasin për seksin
nuk flasin për çmenditë
të martuarit sillen me dashamirësi
si miq të vjetër e t' mirë
ose armiq të përbetuem mes zënkash
që shtohen me kohën
një marrëveshje e pashkrue me krerësh të shpisë
për urrejtjen nuk flitet megjithatë
siç nuk flitet për dashninë
as të bërit dashni
për shpirtin vetmitar aq më pak
andrrat e vdekuna e mërzinë
të martuarit janë gurë të shpërlamë uji por
janë aty

ATO QË S'NA TAKOJNË S'NA NGJAJNË

erdhe një pasdite prilli
me m'takue pranë danubit
the se barkën tashma e ke braktisun
jam askushipëshpërisje
premtova se s'kam me të kërkue asgjë po
shpirti m'tradhtoi
dhe ashtu pa dashje të preka
për një çast u mbështete në krahun tim
u tërhoqe dhe shkove e unë
u desh me të lanë me ikë
ato që s'na takojnë s'na ngjajnë

në qytetet e padukshme nuk gjeta udhë
e ti s'dite me rruu' në qytetet e mia
muj veç me t'lanë me ikë
kurrë s'ka qenë e imja
ajo barkë
ai njeri
ato që s'na takojnë s'na ngjajnë
në barkën tande qetë u ule
e unë nisa lundrimin nëpër danub
s'muj me e shkruar çfarë paska qenë e shkrueme
s'muj me e shkruar çfarë s'paska qenë e shkrueme

TYMI I CIGARES

paqe e paskaj banon n'tymin e cigares
dhe ajo digjet e digjet
e s'pushtohet
si shpirti

e vështror tymin si me e vështruar botën
pa u çue prej shtratit
ai që s'ka lindë për këtë
kurrë s'ka me ia kuptue paqen

shijoj në këtë vështrim
çlirimin
nga e tanë bota

THASË

dhe kështu
erdhi koha me i mbledhë plaçkat e me ikë
me e mbledhë jetën
me e zhvendosë prej apartamentit të vogël
në një të madh

thasë të zinj e thasë të bardhë
asgjë nuk futet kollaj aty
një jetë e palosun mirë
e ngushtueme nëpër dollapë
rroba, këpucë, brekë, unaza, fotografi e korniza të zbraza
vathë të mëdhenj vathë të ndryshkun harruem nëpër kuti
libra të vjetër e të rinj
libra në çdo anë
po qysh e zënë thasët jetën palë-palë
të ngjeshun të rrasun të zipueme
të palueme e të shpalueme
m'shapërderdhet nëpër thasët e zinj e të bardhë
copë-copë jeta ime e palosun me kujdes
erna e parfume përhapen nëpër dhomë po
para largimit dikush duhet me i mbledhë sendet
burri ma bën me dije se koha po shkon
e unë nuk di qysh me e mbledhë jetën copë-copë
me e ba duq nëpër thasët e bardhë e të zinj
thasë najloni thasë të konoptë thasë letre
një copë jetë diku një diku tjetër
kujtimet e palosuna mirë kam tutë me i shpuplue
një qafore një bylyzuk një bluzë e bardhë
të gjitha bluzat e zeza
dikush duhet me i mbledhë sendet
me i futë nëpër thasë e me i bajtë
deri sa të vnojnë pluhun sërish
qiellin e katit të tetë me e futë në ndonji thes të zi
të kaltër a të hirtë
në çfarë thesi me të shti ty
n'cilin thes me hy unë
thasët u sosën
s'kam thes për çizmet e zeza
për pallton prej kashmiri
do thasë hua për jetën time kush i ka
do thasë hua
me i shti andrrat e mia
nji nga nji me i palue mirë
thasë të endun me fije bimësh për jetën që refuzon
me ardhë me mue
me i palue kujtimet e mia n'thasë të mëndafshhtë
n'ata thasë ngjyrë purpuri
po dikush duhet me i mbledhë sendet para largimit
edhe pluhunin edhe llumin edhe rrjetat e merimangave
me e lanë pastër për pronarin e ri

mjerisht ka diçka që s'e zë thesi
ka thasë aq të vegjël e thasë gjigantë pa grykë pa fund
që s'i ngre dot

PASQYRË

kam pasë po andrra shumë
kam pasë qiej në të cilët kam fluturue
një ditë i mbylla sytë e kur u zgjova
engjëjt m'i kishin marrë
m'i morën përgjithmonë mbi krahët e tyne

ditët e mia kalojnë pritja e ka humbë magjepsjen
po rruojtjendue mbi kalimin
kam pasë po andrra shumë
po s'pata nji thes ku me i ruejtë

kam pasë një dhomë me pasqyra shumë
para të cilave krijha flokët
dhe isha unë
në çdonjërin nga ato

kam pasë një dhomë me pasqyra shumë
para të cilave isha unë
në secilën nga ato kisha nga një andërr
po engjëjt m'i morën përgjithmonë mbi krahët e tyne

kam pasë gjumin tim
dikush më zgjoi
mos me m'lanë me fjetë ma
një ditë një fëmijë më deshi
isha shumë e lumtun
kjo m'u duk e pabesueshme
kam pasë gjumin tim
dikush më zgjoi pas kaq shumë vitesh
mos me m'lanë me fjetë ma

kam pasë një dhomë me pasqyra shumë
një ditë u afrova e kur u kqyra
pash se isha plakë
dhe nuk isha unë në ndonjërin prej tyne


ah, po prit
a mos isha shndërrue unë në pasqyrë
dhe dikush ja bash tash po shikohet në mua
s'e kap dot
ma e bukur me u këqyrë në pasqyrë
a me qenë pasqyrë
të kesh pasqyrën në xhep
a të jesh pasqyrë në xhep
o ti që mundesh me m'mbajt në xhep
këqyru njilherë në mua dhe më thuaj çfarë po sheh

TRUPIN E LASHË ME BANUE ME TY

trupin e lashë me banue me ty
ti e ndave copash
organet e mia i shpërndave nëpër qiej
u habita me kënaqësinë tande të mishit dhe
u zhgënjeva nga banimi n'atë shpi
dashnia nuk krijohet në vetmitë e virgjëra të mishit
tash ato copa që i more
mbaji për vete

NJË ZË I BUKUR POETIK

(Saranda Mehmedi, POIESIS, Sigmappres, Shkup, 2021)



Ndue UKAJ

Fjala poezie ka origjinë te termi antik poiesis dhe do të thotë krijim. Kjo domethënë se përmes gjuhës, poetët krijojnë realitete gjuhësore e estetike që s'kanë ekzistuar më parë; krijojnë botëtë reja, ku banojnë qenie që shprehin gjakimet, tregojnë ëndrrat, ëndërrimet, sfillitjet, gëzimet, hidhërimet, vëzhgojnë realitetet përreth dhe të gjitha këto ndjesi i kthejnë në poezi.

Ky është poeieis-i, një koncept antik për artin, që mishërohet në secilën qenie krijuese, duke ruajtur mësimin shembullor aristotelian që poiesisin e konceptonte si një zgja-

tim i asaj se si mund të jetë një krijim i nivelit të lartë i intelektit njerëzor. Poezia s'mund të përkufizohet pa u tretur, thotë H. L. Borges. Dhe të tretësh poezinë, domethënë të ushqesh me magjinë e gjuhës, imagjinatës dhe tingujt magjepstë poezisë.

Dihet prej kohësh se asnjë temë dhe asnjë drithërimë njerëzore s'është e huaja për poezinë, sepse qenia e saj është pa skema, gjuha e saj është pa limite: s'iu nënshtrohet dogmave, doktrinave, ideologjive, pushteteve. Pra, bota e saj - ose thënë ndryshe - bota që vëzhgon poezia, është jeta në tërësi dhe si tërësi. Si e tillë, poezia lundron nëpër thellësi, ngjitet

nëpër lartësi dhe në trajektoret e saj s'kërruset përballë skemave të kohës, i tejkalon, sepse është tejkohshme dhe zë madhështor i lirisë.

Pra, krijuesi përsëdytë filozofinë e zanafillës. Dhe krijon një rruzullim poetik të vetin, plot jetë, gjallëri, ku ndeshen e mira dhe e keqja, dëshirat zhuritëse përballë atyre që i pengojnë ato, siç bën Saranda Mehmedi në këtë përmbledhje të bukur poetike, të shkruar me intuitë krijuese dhe figuraciongoditës. Poetja memprehtësi i percepton fenomenet njerëzore dhe ato i kthen në art. Dhe në botën e saj krijuese, vërtitet jeta, nga djepi deri te "Uji i shiut"

që
bie
si
gjilpëra
dhe me pe të tejdukshëm
arnon trishtimin tim,
një trishtim, që në fakt,
s'është as i imi
një trishtim
i padukshëm
një trishtim që padukshëm
shpon
një trishtim që rri pezull
një trishtim që unë e shoh
dhe e përqafoj me sy."

Kështu, poezia e saj kthehet në një jehonë që frushkullon shtypjen, është rezistencë estetike e morale kundruall mendësive kufizuese dhe atyre që rëndojnë mbi lirinë si domosdoshmëri e ekzistencës njerëzore.

Historia është pejzash i jetës, përmes së cilës jetojmë dhe formësojmë të vërtetat e reja. Saranda këtë të vërtetë na dëfton në variante të ndryshme poetike dhe e transmeton me nota melodike, përmes kujtesës, ninullave dhe të vërtetave të trishta, për jetën e mësuar përmendësh, për fjalët e bërtitura, për ramjen e lehtë, për historinë dhe të vërtetën e trishtë që na dëfton ajo: se gjithçka është e vjetër në këtë rruzull, për bukurinë, për mënyrën si përfytyrohet Zoti, për shiun e tingujt e trishtimit që bien në vargje, për kostumin e heshtjes... Ky libër fillon me

poezinë "Përkundje", ku poetja kuvendon me veten, e përkund veten dhe si në ninulla, i fut ose i zgjon nga gjumi dëshirat, ëndrrat, heshtjen, mendimet, gjakimet dhe në fund thotë:

"Më përkundin. Më përkundin. Më përkundin.
por unë jam zgjuar...
dhe gjithçka që zgjohet
nuk është më njësoj."

Poezia "Kur jeta mësohet përmendësh" është një rrëfim unik poetik, ku përmes gradacionit poetik, përshkallëzohet revolta poetike kundrejt jetës së mësuar përmendësh, që mund të ngajë në një vjershë të shkruar keq. Dhe ajo kujton veten dhe lexuesin se përmendësh jeta është mësuar përherë:

"nëpër zërin e egër dhe kërcënues
të predikuesve e perandorëve..."

Dhe krejt kjo dramë ngjet ngaqë revolta është mbytur në gjumë të thellë, të cilin poezia e shkund, dhe shpërthen revolta estetike e morale:

"këpucët e jetës që na mësojnë
përmendsh
vrasin
shputat e mendjes, zemrës
dhe kohës..."

thellë brenda vetes
mbesim fëmijë të trembur."

Ninullat, historitë, dhimbjet njerëzore, gjakimet për të vërtetën e të bukurën, në gjuhën e poezisë përherë shfaqen si risi, kurrë s'janë të vjetra, janëgjallëri dhe kërkohen lexues që i tretin, dhe siç thotë poeti i madh Czeslaw Milosz, në momente kataklizmash, poezia bëhet e njohur si shprehje e shpresës, aspiratave dhe identitetit njerëzor. Kjo përmbledhje poetike, e botuar në shqip dhe në maqedonisht, është shprehje e bukur e shpresave, aspiratave dhe identitetit të një zëri të bukur poetik.

ESTETIKA E HEIDEGGER-it DHE POEZIA E PORADDECIT

Hajdegeri artin e definon përmes estetikës ontologjike, ngjashëm me Nikollaj Hartmanin, i cili duke e ndarë veprën artistike në dy plane, material dhe metafizik, themeloi estetikën ontologjike



Afrim REXHEPI

Me vetë faktin që u kthye të studiojë filozofinë dhe estetikën parasokratike, arriti të afrojë filozofinë dhe estetikën metafizike më afër ekzistencës. Është merita e tij, që arriti ta definojë hermeneutikën si strukturë e qenies që realizohet apo vetëpozicionohet përmes gjuhës, përmes asaj gjuhe të thjeshtë, pragmatike, të gjallë. Estetika e Hajdegerit, në thelbin e saj është antiestetikë në raport me estetikën subjektivistë të Kantit. Sipas tij, arti është poezi, kurse poetikja është diktati i qenies që ndodhet në gjuhë. Në projektin e tij për desubjektivizimin e shijes, Hajdegeri distancohet nga nocionet thelbësore të estetikës subjektivistë: shprehja e përvojës dhe afektiviteti. Në fakt, nocionet shënojnë konfrontimin pozitiv midis gjuhës së poezisë dhe ekzistencës së subjektit. Formula e tij, Unë nuk e flas gjuhën, por ajo më flet, më shpreh mua, e kupton faktin që gjuha nuk është shprehje e subjektit, por i paraprin subjektit. Pra gjuha është fenomeni më i rrezikshëm që lidh skajshmërisht, tokën / qiellin, kaosin / kosmosin etj. Pra, një lidhe oksimoronike, e që realizohet përmes një përplasje sublime të të kundërtave, zbulon të vërtetën e objekteve, të fshehtë e qenies, apo të fshehtë e të fshehtës, siç do të thoshte Lasgushi. Në kontekst, Hajdegeri, i ka interpretuar ata poet të cilët mendojnë (Helderlini, Rilken Rembo etj.), ata poet që në veprat e tyre, poezia ishte problemi më i madh. Me të drejtë Çabej, në tekstin e tij për Lasgushin, shprehet se ai i ngjan poetëve si Helderlini, Rilke, Trakël etj.

Në fakt, Hajdegeri artin e definon përmes estetikës ontologjike, ngjashëm

me Nikollaj Hartmanin, i cili duke e ndarë veprën artistike në dy plane, material dhe metafizik, themeloi estetikën ontologjike. Dallimi qëndron në faktin se Hajdegeri veprën e ndan në dy plane. Planet nuk lidhen njëra me tjetrën, por përplasen dy faktorë fundamental: toka dhe bota apo tek Lasgushi toka dhe qielli, së bashku kaosi dhe kozmosi. Gjithnjë sipas Hajdegerit, vepra artistike është zbulimi i sublim, në të cilën zhvillohet përplasja midis kategorive të kundërta. Ngjashëm me Heraklitin, i cili logosin e definon si një shkrirje funksionale e

të kundërtave. Pra, arti krijohet në kalimin e çastit sublim, duke zbuluar ndritësimin e gjërave të fshehura, kur materia kalon, shndërrohet në energji. Në këtë mënyrë, zbulohet e vërteta e të vërtetës, në përplasje, në dridhje, në tension të thellë, ndritësohet fshehtësia e qenies. E vërteta është objektive dhe ekziston si e tillë. Pra, sipas Hajdegerit, poezia është gjuha e parë e popujve, e poetët barinj që ruajnë qenien. Poetët jo vetëm që janë në ekzistencë, por ata ndodhen në fill të saj. Në kontekst, parashtrrohet pyetja, Kush e krijon të vërtetën apo fshehtësinë e fshehtësisë? Të vërtetën nuk e krijon poeti, sepse poeti është subjektiv, e vepra artistike nuk është objekt por është vepër arti në të cilën e vërteta ndodh krejt spontanisht, si proces natyror. Që do të thotë se vepra e artit nuk është shprehje e artistit por shprehje e të vërtetës që natyrshëm vendoset në vepër. Hajdegeri mendon që artistët e mëdhenj, thjesht shkrihen me artin e tyre, sa që vepra shndërrohet në një lloj depersonalizimi, indiference. Pra, arti është ontocentrik. Me vetë faktin që ne pozicionohemi para imazhit, e vërteta ontologjike, si akt sublim, ndodh midis ne dhe veprës. Kështu ne përfitojmë bindje më të thella për ekzistencën, për gjërat që janë ç'do ditë me ne.

Në fakt, realizimi i kritikës subjektivistë në Estetikë, funksionalizohet përmes tre elementeve kyçe të subjektivitetit që janë: përvoja shqisore, kënaqësia dhe e bukura. Tendanca e Hajdegerit është që elementet kyçe të distancohen nga arti, e të vijë në shprehje pastërtia ontologjike e gjërave. Ideja fenomenologjike e Huserlit "kthimi kah bota e jetës", kah e vërteta e të vërtetës, është në funksion. Kjo është kështu, sepse në estetikën tradicionale, ndodh hegjemo-

nia e subjektit. Desubjektivizimi i shijes, realizohet duke i mohuar nocionet kyçe të estetikës subjektivistë: shprehja e përvojës së shijes, e përjetimit dhe afektiviteti. Kështu funksionalizohet përvoja e të vërtetës, që në fakt ndryshon nga përvoja metafizike, dominante kjo e estetikës subjektivistë. Në kontekst, forca e poezisë së Poradecit, është në gjithpraninë apo në plotninë e saj në raport me konkretin në të cilën shfaqen përjetësia e të kundërtave ekstreme, siç janë: toka - bota te Hajdegeri, toka - qielli te Lasgushi, apo ke të dy së bashku, kaosi - kozmosi, pikëllimi - gëzimi etj. Për shembull, figura e Nositit, që ngërthen në vetë simbolikën, sinestesionin, është një figurë (metaforë) semiotike e gjallë, që nuk pranon diktatin e metafizikës ndaj materies apo objektit. Perceptimi i kësaj figure vet-flijuese, nuk mund të jetë subjektive apo psikologjike. Figurën e Nositit, nuk mund ta perceptojmë si një të vetme, të bukur. Estetika mund ta perceptojmë në lëvizje apo vetëm si një figurë oksimoronike që manifeston lidhjet. Në dukje pikëllimi dhe gëzimi:

Pa nis ah! gjirin t'a godas...

Dh' e hap ah!-gjirin më një ças...

Dh' i ngjin ah! zogjtë-e vdes me gas!...

Pra, jo si figurë metafizike, por si figurë që krijohet nga tensioni, si figurë subline dhe historike.

Antiestetizmi i Hajdegerit, është ngushtë i lidhur, në kuptimin që është problematik me nocionin perceptiv estetik (aisthesis). Duke e përjashtuar një nocion të tillë, ai distancohet nga disa "modernist", të cilët veprën artistike e perceptojnë si fenomen subjektiv, atë estezis të pastër, thellë të inkuorporuar në rrafshin shqisor të artit. Nëse estetika bazohet në kategorinë perceptim, përjetim, atëherë përveç recipientit, duhet të funksionalizohet edhe ekzistenca e

subjektit krijues. Në shkrirje të ekzistentëve, rezulton relativiteti kohor, ku arti humb në aktualitet. Që do të thotë se arti ngadalë por sigurt vdes në kohë, por mbetet funksionale vepra në përjetësi. Pra, arti nuk mund të ekziston në formën e dhënë të objektivitetit historik. Në kontekst, parashtrrohet pyetja, Çfarë ndodh me artin, me poezinë, kur kategoria e saj thelbësore perceptiviteti, përjashtohet nga modusi i saj? Çka nëse vepra dislokohet nga elementet e subjektivitetit, pra nga krijuesi, recipienti dhe perceptimi? Ndodh funksionalizimi i ontocentrit, ku shijuesi tërhiqet nga akti sublim, nga e vërteta e të vërtetës apo nga fshehtësia e fshehtësisë. Zbulohet qenia për tjetrin dhe qenia në lidhje me tjetrin, si përjetësi historike.

Bashkohesh brenda me përjashtësi/
Bashkohesh jashta me përjashtësi/
Bashkohesh tretesh me përjetësi.

Me të drejtë, shkruan Moikom Zeqo, që vepra e Lasgushit, është unikale, e paprekshme dhe jashtëkohore. Pra arti është fenomen i tillë, që vetvetiu e vendos të vërtetën e qenëzuar. Ç'ndodh me poetin. Poeti e tejkalon subjektivitetin përmes ekzistencës. Edhe pse shndërrohet në një lloj transmetuesi, përsëri mbetet pjesë integrale e të vërtetës objektive. Interpretimi i estetikës së Hajdegerit në poezinë e Lasgush Poradecit, tregon në faktin që:

- janë ekzistente impulset e para të estetikës fiziologjike;


- përforcon bindjen e Çabejit që poezia e Lasgushit ka një emocion shpesh të përparfërt me ekzistencën;

- përforcon bindjen atë të Moikom Zeqos që Lasgushi e ka emancipuar poezinë shqipe ndërmjet një estetike, si pakkush në të gjithë shekujt letrarë të Shqipërisë.



MOS MË NGACMO, MUSHKONJË!

(Parathënia e monodramës "Vrasja e mushkonjës", botuar nga shtëpia botuese "Armagedoni", Prishtinë, 2020)



Xhevdet Bajraj ka lindur në Panorë të Malishevës. Ka studiuar për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Deri në vitin 1999 ka jetuar në Rahovec, ndërsa pasi mori bursën e Parlamentit Ndërkombëtar të Shkrimtarëve shkoi në Meksikë, në të cilën jeton dhe punon profesor në Akademinë e Krijimitarisë Letrare në Universidad Autónoma de la Ciudad de México (UACM). Bën edhe përkthime të teksteve nga gjuha spanjolle në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Veprat e Bajrajt janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë shpërblyer me çmime të ndryshme. Poezia e tij është përfshirë në disa antologji botërore, në të cilat poeti ka përfaqësuar poezinë shqipe dhe atë meksikane. Ka botuar mbi 15 vepra në gjuhën shqipe, mbi 14 në gjuhë të huaja, ka përkthyer pesë vepra në gjuhën shqipe, ka hartuar dy antologji të poezisë (njërën meksikane e tjetrën shqipe), ka marrë shtatë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kjo monodramë, të cilën po ia botojmë për herë të parë nëntë vjet pas vënies në skenën e Teatrit Kombëtar të Kosovës, në vitin 2011 ka marrë çmimin e parë në konkursin "Katarina Josipi" për dramë origjinale shqipe shpallur nga Ministria e Kulturës e Kosovës.

Vrasja e mushkonjës mund të perceptohet si një rrëfim për konfuzionin në shoqëri, për mungesën e vetëbesimit, për mungesën e shpresës, për kërcënimin nga pushteti autoritar, për dhembjen, për zhgënjimin nga politika dhe nga partitë, për injorancën, për njerëzit me maska. Ndër të tjera, në të shihet edhe dhembja për atdheun pa dashuri, përplot tradhti e gënjeshtër, me mashtrues kudo në organizata joqeveritare, të "përfaqësuesit" e Perëndisë në Tokë, në institucione, rrugë, shtëpi...

Fragment nga parathënia e Agron Shalës

E shpërblyer me çmimin e parë në konkursin për dramë shqipe "Katarina Josipi" shpallur nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës

VRASJA E MUSHKONJËS

monodramë
nga Xhevdet Bajraj

Me parathënie nga Agron Shala

Agron SHALA

Vrasja e mushkonjës është monodramë poetike. Dikush mund të thotë se me Henrik Ibsenin, që nga fundi i shekullit XIX, vargu poetik u bë teatër i tejkualuar. Por, të tejkualuar kurrë nuk do të jenë emrat e njohur të dramaturgjisë botërore si Eskili, Sofokliu, Shakespeare, Racine... madje as Ibseni që ka thënë se skena është veç për artin dramatik dhe deklamimi nuk është art dramatik. Me këto fjalë që ia thotë një aktoreje, u thyen konceptet e dikurshme se dramati serioze shkruhen në vargje e se komeditë shkruhen në formën prozaike. Por, veprat e tij deri te Peer Gynti, që janë shkruar në vargje, kanë bërë që kritiku i teatrit, Richard Hornby, ta cilësojë Ibsenin si një dramaturg poetik – më të mirin që nga Shakespearei. Sepse, sado që mund të duken forma të ndryshme arti, teatri ka nevojë për ndjesinë poetike siç për të ka nevojë muzika, fotografia, filmi, koreografia... madje edhe matematika. Pastaj, artet ndërthuren, ndaj poezinë e gjen kudo tek e bukura – si dëshmi të estetikës, si dëshmi të jetës (Leonard Cohen).

Dikush tjetër mund të thotë se monodrama është tekst i vështirë për

t'u vënë në skenë, mbi të gjitha nëse është i shkruar në vargje. Por, janë plot tituj modernë – si Die Hamletmaschine (Hamlet Makina nga Heiner Mueller) apo Die Zeit und das Zimmer (Koha dhe oda nga Botho Straus) – që janë më të vështirë për inskenim. Këtë të fundit pati dije dhe guxim ta inskenojë, p. sh., i madhi Ingmar Bergman. Prandaj, në rastin shqiptar problemën duhet kërkuar tek aktorët dhe regjisorët trima deri në marrëzi; tek të gjithë ata që dinë të lexojnë shkronjat dhe fjalët, por jo edhe kuptimin. Në këtë aspekt ia vlen të cekim pikëpamjet e regjisorit të njohur të filmit Andrei Tarkovsky (poetit të madh të kinematografisë, për të cilin kinemaja autor – regjisor i cili krijon botën e tij, pa riprodhuar realitetin rreth tij – është e përbërë nga poetët). Për Hamletin e Shakespeareit ai ka deklaruar se nuk ka nevojë për interpretim, se veç është e nevojshme ta lexosh atë që Shakespearei e ka thënë. E përderisa Shakespearei ka folur për problemet absolutisht të përjetshme, të cilat gjithmonë kanë rëndësi, Hamleti në çdo kohë mund të vihet në skenë. Por, Tarkovskyt nuk i pëlqenin inskenimet që i janë bërë, qoftë në film apo në teatër, madje edhe ato të

regjisorëve të njohur – si Grigori Kozintsev, Laurence Olivier apo Peter Brooke – për të cilët ka thënë se nuk kanë ditur ta lexojnë këtë vepër të madhe të dramaturgjisë botërore!

Vrasja e mushkonjës duhet lexuar sepse është vepër e Xhevdet Bajrajt – një prej poetëve tanë më të çmuar e më të veçantë. Por, si vepër e dedikuar për skenën, duhet lexuar tamam mirë, duke i bërë edhe një analizë jetës dhe veprës së autorit: një rokeri të hershëm, me flokë të gjata, që v ishte këpucë ushtrie, xhinse dhe vietnamkë, e që me vëllanë e vet, Fadilin, ishte një nga koleksionistët e parë e ndër më të mëdhenjtë shqiptarë – jo vetëm në Kosovë – të disqeve të muzikës rok. Pra, i theu shabllonet që imponoheshin nga rrethi dhe nga ajo që sistemi komunist kërkonte, duke zgjedhur të jetonte sipas asaj që besonte.

Rokerët janë ëndërrimtarë. Ata akoma besojnë në një revolucion shpirtëror që do t'i zhdukte ndasitë mes njerëzve. Por, teksa e proklamojnë lirinë, paqen dhe dashurinë, janë edhe kritikët më të mëdhenj të së keqes, në cilëndo shoqëri qoftë ajo. Në këtë aspekt duhet parë Bajrajn e poezinë e tij – si homazh për të mirën

e të bukurën, dhe si reagim ndaj çdo padrejtësie (me të gjallët e me të vdekurit). Prandaj, kur i ke parasysh këto, te Burri – karakteri i monodramës së tij – menjëherë vërehet një rebel. Ai nuk përshkruhet me fotografi, por imazhet për të dhe për botën e tij dalin nga vargjet e Bajrajt. Kështu, tek ai shihet Pinku (personifikimi i rokerit tragjik Syd Barret, te filmi The Wall/Muri) apo Henry Chinaski (alter egoja e Charles Bukowskit në filmin Barfly/Pijane-ci); shihet fatkeqësia e artistit dhe artisti bohem; shihen artistët e guximshëm që assesi nuk bëjnë kompromise; shihen rolet mjeshtrorë të bëra nga Bob Geldof dhe nga Mickey Rourke; shihet një rok-operë dhe një dramë... shihen sharlatanët tanë të artit skenikë dhe një dëshirë e madhe për të pasur sa më shumë idealistë e regjisorë si Alan Parker dhe Barbet Schroeder.

Xhevdet Bajraj ka vite që jeton në Meksiko Siti. Është profesor i Letërsisë dhe i Shkrimit Kreativ në Universitetin Autonom të Meksiko Sittit – një prej qyteteve më të mëdha në botë dhe më i vizituar në Amerikën Latine. Në fakt, Meksika gjendet çdo vit në listën e 30 shteteve më të vizituara në glob. Një nga vizitorët e

shpesh të shtetit dhe qytetit ku jeton Bajraj, është Robby Krieger – kitaristi i rok-grupit legjendar poetik, The Doors. Gjatë një vizite të tij në Meksikë, në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar, tekta e dëgjonte një këngë të interpretuar prej tre mariaçëve, që flisnin diçka për mushkonjat, Krieger merr frymëzimin për këngën eklektike The Mosquito (Mushkonja). Kënga ka veç tri vargje të shkurtër, ku kryesori është: Mos më ngacmo, mushkonjë. Ky varg e zbërthen bezdisjen që shkaktojnë mushkonjat në një vend me klimë subtropikale. Por, edhe natyrën e së keqes që këmbëngul në diçka, pa çka që irritohet apo lëndohet tjetri.

Në Meksiko Siti u shkrua edhe monodrama e Bajrajt, por ky frymëzim vjen nga mushkonjat 11 mijë kilometra larg; nga ato të Kosovës (apo të Shqipërisë), që nuk i lënë të qetë shqiptarët e drejtë, shumicën, kudo ku janë ata. Prandaj, Vrasja e mushkonjës është një lloj proteste, me mesazhe dhe mendime që tejkalojnë kufijtë gjeografikë të shqiptarit të Ballkanit. Sepse, mushkonjat janë të njëjtat kudo: krijesa të vogla, fort të shëmtuara, që bartin viruse dhe parazitë nga njëri tek tjetri; janë krijesat më vdekjeprurëse dhe më gjakpirëse në Tokë, që thithin tri herë më shumë lëngje se pesha që kanë...

Po çfarë u bënë shqiptarëve "mushkonja" e Bajrajt?

Teksti dramatik nga shumëkush shihet si tekst i hapur, pra se përfundimin e jep regjisori. Kjo është e arsyeshja se pse, p. sh., ekzistojnë shumë interpretime të Hamletit. E njëjta mund të vlejë edhe për Vrasjen e mushkonjës, ku Burri është një anti-hero, heroizmi i vetëm i të cilit duket se është "shpëtimi" i verës e i rakisë së Rahovecit nga ngujimi në shishe – si një mekanizëm mbrojtës dhe si reagim ndaj realitetit të keq që ka kapuar vendin e tij. Ai nuk vepron, por as nuk rri i heshtur e as nuk bëhet aleat i së keqes dhe i të keqit. E jeton jetën siç do vetë. Flet dhe rrëfëhet. Për hallet e të vërtetën. E kush i shpreh këto më mirë se një i dehur? Sidomos ai që i përmbush tre "eliksiret" e Charles Baudelaireit për dehe (si një kthim në normalitet në një shoqëri të vlerave inverse): Me verë, me poezi apo virtyt, si të duash. Por, dehu!

Kështu, Vrasja e mushkonjës mund të perceptohet si një rrëfim për konfuzionin në shoqëri (Nuk e di nëse unë jam duke qëndruar kokëposhtë/ apo bota është përmbys), për mungesën e vetëbesimit (Zot i asgjësë dhe më shumë se kaq/ jam vetë asgjëja), për mungesën e shpresës (me barkun plot dhe shpirtin bosh/ e ndërsa koha ikën duke ia vjedhur ditët/ ardhmërisë), për kërcënimin nga pushteti autoritar (që ua ledhatonte flokët fëmijëve/ edhe pse mund t'i vriste që të gjithë), dhembjen (vaji i pëllumbeshës nënë/ kur e sheh djalin e saj/ me fluturimin e ngecur në fyt), zhgënjimin nga politika dhe nga partitë (qofshin pozitë apo opozitë/ janë mut i njëjtë... partitë kryesore

kanë rënë dakord/ për të mos njohur vullnetin e popullit), për injorancën (Se duke lexuar mbeturina duke ngrënë mbeturina/ jemi shndërruar në mbeturina), njerëzit me maska (me role të njëjta/ në të njëjtin teatër/ vetëm maskat do të jenë të ndryshme)... Aty shihet edhe dhembja për Atdheun pa dashuri, përplot tradhti e gënjeshtër; me mashtrues kudo – nëpër organizatat joqeveritare, tek "përfaqësuesit" e Perëndisë në Tokë, nëpër institucione, nëpër rrugë, në shtëpi...

Te Vrasja e mushkonjës shihet frika për fatin e poetit, sepse sa herë që shteti rrëshqet e sundohet nga politikanët që vuajnë nga kulti i personalitetit, atëherë ndodhë ajo që ka parashikuar poetja Lenore Kandel: Kur një shoqëri fillon të ketë frikë nga poetët e vet, kjo do të thotë se ka frikë nga vetja! Në rastin e tillë rrezikohet e bukura dhe secili artist, meqë mund ta ketë fatin e poetëve që përmendën në monodramë – viktimat të regjimit totalitar komunist në Bashkimin Sovjetik: Daniil Kharms e luajti rolin e të çmendurit për të mbijetuar, por vdesë nga uria në Sanatorium gjatë rrethimit të Leningradit; Osip Mandelstam u internua dhe vdiq nga uria në gulag; Vladimir Mayakovsky, Sergei Yesenin dhe Marina Tsvetaeva bënë vetëvrasje; e Anna Akhmatova, pas shumë e shumë vuajtjeve, dha shpirt nga zemra e plastë.

Meqë Poezia është më afër të vërtetës jetike se historia (Platoni), monodrama e Bajrajt e pasqyron kohën kur u shkrua. Por, fatkeqësisht, është aktuale edhe sot. Sepse, mushkonjat dhe të ligat e tyre akoma janë mes nesh! Një e keqe, një mushkonjë. Një mushkonjë me shokë shumë. Luftë kjo e pamundshme për një njeri.

Por...

Njëherë e një kohë, një luan nuk u soll mirë me mushkonjën. Mushkonja hakmarrëse i thirri miqtë e vet e me ta i turret luanit. Mbreti i shtazëve ikën i frikësuar. Teksa lutet për jetë, bie turpshëm në ujë. Ndërkohë, mushkonja e lumtur, por e ekzaltuar nga fitorja, bie papritmas në rrjetën e merimangës! Morali i kësaj përralle indiane është: mos i nënvlerëso gjërat e vogla e as mos e hup mendjen me fitoret e mëdha!

Deri atëherë, pra kur mushkonja prijatë do të bie në rrjetën e merimangës, ti rri i dehur (normal), jeto siç ndien (si roker) dhe hakmerru (injoro, si Burri në fund të monodramës). Por, vazhdo të shpresosh si ai poeti që thoshte në një gazetë: Pasi që jemi të rrethuar me errësirë/ unë e kafshoj atë dhe pastaj dhiej dritë/ natyrisht/ dritë e arsyes!

Për fund, vlen të ceket edhe diçka për vargun e bardhë, pa rimë e pa masë të rrokjeve me të cilën identifikohet poezia e Xhevdet Bajrajt. Në një debat për dramaturgjinë në vargje, kritikja e teatrit, Lyn Gardner, ka thënë së voni se vargu i bardhë është i lehtë për veshin dhe mrekullisht modern. Vrasja e mushkonjës është vepër e tillë. Prandaj, lexojeni!



Allen Ginsberg

NË SHOQËRI

Hyra në dhomën
ku mbahej kokteji
dhe gjeta tre a katër pederë
që kuvendonin në zhargonin pederast.
Provova të jem i shoqërueshëm por
dëgjova veten duke folur me zhargon hipsterësh
"Më vjen mirë që të shoh", tha ai, dhe
largoi shikimin. "Hëëë", mendova. Dhoma
ishite e vogël dhe kishte krevat dysh
dhe pajisje kuzhine:
frigorifer, dollap, toster, stufë;
mikpritësit dukej se kishin vend të
mjaftueshëm vetëm për zierje dhe fjetje.
Vërejtja ime për këtë çështje u kuptua
por nuk u pranua. Më ofruan
pije, që e pranova.
Hëngra has senduic mishi; një
senduic të pamasë prej mishi njeriu,
vërejtja, derisa e përtypja,
se përmbante po ashtu edhe bythë të ndyrë.

Edhe më shumë erdhën, duke përfshirë
edhe një femër pushtake që dukej si
princeshë. Më shikonte me inat dhe
aty për aty tha: "Ti, nuk më pëlqen",
ktheu kokën dhe refuzoi të njohet.

"Çfarë!", thashë i fyer.

"Përse, ti budallaqë fytyrë muti!"

Kjo ua tërhoqi vëmendjen të gjithëve.

"Pse ti bushtër narcisoide! Si mundesh ashtu
të thuash kur bile as që më njuh",
vazhdova me zë të ashpër dhe mesianik,
i inspiruar më në fund,
duke mbizotëruar tërë dhomën

Ëndërr, Nju-Jork - Denver, Pranverë 1947

DY DJEM U FUTËN NË NJË RESTORANT ËNDRRASH

dhe hëngrenë goxha shumë fatura arriti në pesë dollarë,
ama ata nuk e kishin idenë
se në çfarë ishin futur
kështu që me lopata

ngarkonin plehrat në kamion në një rrugicë
për ta shpaguej ushqimin.
Pas nja pesë minutash, vrisnin mendjen se
deri kur do të duhej të punonin

për të paguar çmimin e duhur, pyetën
pronarin e restorantit se kur
do të merrte fund ndëshkimi ose pagesa.
Ai qeshi.


Sa pak kuptonin – ishin aq
virgjëror -
nga që një punëtor i regjur punonte gjysmë dite
për njato para.

Paterson, në mes të vitit 1950.

Përktheu: Fadil Bajraj

MBI POEZINË "FINDLEJ" TË ROBERT BËRNS

Robert Bërnës është një indicie kuptimplote e lëvizjes romantike dhe poezia "Findlej" përbën pikërisht një nga shtyllat e ndjenjës së vrullshme dhe dashurisë së pastër tokësore, duke paraqitur heronj lirikë të një formati të veçantë



Majlinda RAMA

"Kush troket kaq vonë në derë?" - ky është vargu hyrës i bardit skocez, Robert Bërnës në poezinë me titull "Findlej". Nuk është një pyetje retorike. Ajo që të bën përshtypje në pamje të parë, është pikërisht nocioni kohë: "kaq vonë". Kush mund të trokas netëve vonë? Ndonjë shtegtar i vonuar, ndonjë kalorës që ka humbur rrugën, ndonjë bujtës i rastësishëm apo...? Është dikush që lëshon një sinjal pakëz të lehtëshquar dhe pakëz dyshimtar, ndaj dhe pyetja është: "Kush troket kaq vonë në derë?", një pyetje me një zëth femëror. Dhe përgjigja: "Jam unë!" që vjen përtej trokëllitjes së lehtë të derës. Është një përgjigje pa përmendur emër dhe ajo as që vazhdon më tej me një tjetër pyetje: "Kush ti?". Pikërisht kjo heshtje dhe kjo mungesë e pyetjes së dytë, e tradhton vajzën, e gjen atë disi të papërgatitur ndaj asaj që ndjen dhe asaj që përpigjet të shprehë. Pra, ky qenka zë i njohur për të, domethënë, nuk është hera e parë që trokitet në këtë derë, nuk është hera e parë që ai vjen në dritën e hënës dhe vëzhgimin e yjeve për të trokitur në këtë derë.

Por trandja e vajzës fladitet edhe

më tej. Ajo i kujton vetvetes se ndihet e sigurt në atë që ka arritur, një dashnor i krisur që rrezikon orë e çast për të mbërritur te zemra, rrahjet e së cilës duhet të ruajnë qetësinë, por s'mund, duhet të ruajnë fshetësinë, por që prapë s'mund.

Po si guxove te me vish? / "Guxova!" - tha Findlej...

Guxim kalorësiak? Ndonëse nuk është një poezi e damave mesjetare... Mjafton t'u referohesh këtyre vargjeve dhe sheh se Ajo kuturisetillastueshëm, kërkon të dëgjojë dhe bindet nga Ai se është i gatshëm për sfida si kjo e kësaj nate verbuese.

Bërnës nuk do të ndalet thjesht dhe vetëm te njëra anë e medaljes, ajo e sakrificës së të rinjve, por vargu i tij merr përmasa më shumë se dimensionale. Autori parasheh në krijimin e tij dashurinë si nocion dhe këndvështrim gjithpërfshirës, duke tingëlluar deri në thekje "alarmin" e idillit.

Ajo parashtron, Ai pohon; Ajo thërrret, Ai përgjigjet; Ajo lëshon klithmën e parë të parantezës së dashurisë, Ai prapë bëhet pohues deri në vetëmohim: "Do të vij përsëri!"... Autori jo më kot e ka bërë këtë zgjedhje, duke i besuar në rastin konkret detajit,

çastit, fjalës - buruar të gjitha këto nga thellësia e ndjenjës.

Ja, do provoj të të fus brenda./ "Provoje!" tha Findlej/Te rrimë tok, siç na ka ënda / "Do rrimë!" tha Findlej.

Të dy mezi presin. Të dy rendin. Të dy gulçojnë e gufojnë në poezinë e Bërnësit. Ky i fundit, nëpërmjet fjalës së thjeshtë dhe një vargu që vjen natyrshëm, ka arritur të na servirë një tablo të qartë të asaj që duket para derës dhe të asaj që shfaqet underground. Duke iu referuar këtyre vargjeve, shihet qartë një flakë, prushi i ndezur dashuror. Nuk na jepet limitim, as kornizë e asaj që do të ndodhë, por na jepet shumë më shumë e aspak më pak:

"Të rrimë tok siç na ka ënda"

E si mund t'ua ketë ënda të rrinë bashkë dy të rinjve? A munden ata t'u bëjnë ballë krizave që kap çdo ind pranë njeriut që do? Çfarë mund të ndodhë më tej? Autori në asnjë rast nuk na tregon se aty bëhet fjalë për një vajzë dhe një djalë që duhen dhe as na jep momente ku ai i thotë dikund: "Të dual!". Por gjithçka flet, rrëfëhet, ndërthuhet nga ky minidiolog para dhe pas derës, mbi dheun e kaftë, nëpër trokëllimat e kuajve pa frë dhe nën vallen e sapo nisur të yjeve.

Robert Bërnës është një indicie kuptimplote e lëvizjes romantike dhe poezia "Findlej" përbën pikërisht një nga shtyllat e ndjenjës së vrullshme dhe dashurisë së pastër tokësore, duke paraqitur heronj lirikë të një formati të veçantë.

FINDLEJ

Kush troket kaq vonë në derë?

"Jam unë!" - tha Findlej.

Ik se të zunë, o i mjerë!

"S'më zënë!" - tha Findlej.

Po si guxove të më vish?

"Guxova!" - tha Findlej

Kuptohet që ti s'do t'ia dish...

"Kuptohet!" - tha Findlej.

Por në ta hapsha, siç do ti...

"Hape!" - tha Findlej.

Do rrih pa gjumë, o i zi!

"Do rri!" - tha Findlej.

Ja, do provoj të të fus brenda...

"Provoje!" - tha Findlej.

Të rrimë tok, siç na ka ënda ...

"Do rrimë!" - tha Findlej.

Në befshim sonte dashuri...

"Do bëjmë!" - i tha Findlej.

A do vish ti përsëri?

"Do vij!" - i tha Findlej.

Për punën që do bëjmë ne...


"Do e bëjmë!" - tha Findlej.

Ta kyçësh gjer të hysh në dhe!

"Do e kyç!" - i tha Findlej.



ARTI DHE JETA ARTISTIKE NË SHQIPËRINË MODERNE



Në Shqipërinë e dhjetëvjeçarit të fundit kanë ndodhur shumë ndryshime të jashtme. Derisa duken ndryshimet e jashtme, nuk shihen shumë ndryshimet e brendshme, pra në jetën artistike, shpirtërore e arsimore, ndonëse ekzistojnë. Shqipëria, nga ky këndvështrim, është rast interesant dhe i vetëm. Nga një provincë e braktisur orientale, e vogël dhe e varfër, ajo përgjatë dhjetëvjeçarit është bërë një vend modern, ku ka rend dhe lëviz drejt Perëndimit në të gjithë drejtimet. Rrënjët e kulturës perëndimore ngado përhapen në Shqipëri, kurse shpirti i ri, shpirti i kulturës klasike - asaj të krishterë, e ka përfshirë vendin. Kjo vërehet qartazi. Mbreti Zog, gjatë një fjalimi, ka thënë: - Modernizimi shpirtëror i Shqipërisë do të ecë vështirë, më vështirë se sa qytetërimi i atdheut tonë. Por, s' duhet harruar se gjatë katërqind vjetëve të pushtimit turk përherë ka ekzistuar lidhja e hollë, por e artë, me Romën e me Greqinë, pra me kulturën e vjetër klasike. Shqipëria asnjëherë nuk i ka tradhtuar traditat e vjetra. Pikërisht rilindja shpirtërore e Shqipërisë duhej bërë në përputhje me klasicizmin romak dhe grek. Ky klasicizëm, në të vërtetë, u kombinua me notat e modernizmit perëndimor, që i jep ngjyrë të re dhe origjinale kulturës shqiptare- jetës shpirtërore.

Shkenca dhe arti po zhvillohen në paqe

Që të bëhen reforma të mëdha e të guximshme në sferën shpirtërore, sikurse i ka ndërmarrë i riu dhe ambiciozi monarku shqiptar, duhet të njihet mirë psikologjia e popullit shqiptar. Mbreti Zog, gjatë epokës së tij, ka bërë shumëçka që Shqipëria ta siguronte paqen e çmuar. Ai e mbron mendimin se shkenca, arti dhe jeta kulturore mund të zhvillohen vetëm në shteti nuk është siguruar paqja e brendshme dhe e jashtme. Kjo i ka shkuar plotësisht përdore Mbretit të ri shqiptar. Puna shkencore në Shqipëri ka arritur shkallë të lakmueshme. Kujdesi madh i është kushtuar gjurmëve arkeologjike, sepse është mënyra më e mirë që të dëshmohet e kaluara shqiptare. Shumë përmendore të harruara të së kaluarës do të nxirren në dritë.

Nga viti 1927 filluan gërmimet arkeologjike në Butrint. Aty janë bërë punime sistematike në mbikëqyrjen e ekspertëve ndërkombëtarë. Dhjetë metra nën dhe janë gjetur gjurmë mahnitëse të së kaluarës shqiptare, nga periudha e lashtësisë romake. Pranë Sarandës është zbuluar tempulli i Asklepit, i ruajtur shumë mirë, që daton nga shekulli i pestë para Krishtit. Këto janë dëshmi bindëse se shqiptarët e vjetër ishin banorë të këtushëm që në kohën e lashtë. Gërmimet tjera arkeologjike mundësuan zbulimin e shumë pllakave të vjetra, mbishkrimeve dhe gjësendeve të lashta, ku si në një libër të hapur mund të lexohet lashtësia shqip-

tare. Në periudhën romake kishte në territorin e Shqipërisë së sotme teatro, shkolla, spitale dhe institucione kulturore e shëndetësore dhe vetëm barbaria turke mundi barbarisht t'i fshinte gjurmët kaq të ndritshme të lashtësisë. Gjithashtu edhe pranë Fierit është zbuluar një muze i tërë me eksponate. Mbreti Ahmet Zogu ka ndarë shuma të mëdha parash që në vendin e muzeut të vjetër romak, pranë Fierit, të ngritet një muze i madh modern, ku do të grumbullohen të gjitha eksponatet e lashta të Shqipërisë.

Piktura dhe muzika

Përveç hulumtimeve shkencore e gërmimeve sistematike arkeologjike, qeveria shqiptare tregon shumë kujdes edhe ndaj artit. Çdo talenti ri në Shqipëri, edhe kur jeton në skajet më të largëta të Shqipërisë, ndihmohet shumë nga qeveria. Shumë të rinjve me talent dhe dashuri për pikturën, skulpturën dhe muzikën u është mundësuar studimi jashtë shtetit. Ata marrin bursa nga qeveria shqiptare, për të cilat mund t'ua kenë zili bursistët tjerë, sepse qeveria është shumë dorëlëshuar ndaj njerëzve të aftë e të talentuar.

Piktura në Shqipëri sot është në hapat e parë, por shfaqen shenjat e para të një piktore të pavarur dhe origjinale të artit pamor shqiptar. Në Tiranë, Durrës dhe në rajonet tjera janë çelur

disa ekspozita të suksesshme. Aty kanë qenë të pranishëm princeshat dhe Mbreti. Aty u është mundësuar artistëve të rinj ta shprehin talentin e tyre. Përveç disa peizazheve të suksesshme përshkruese, që paraqesin viset e ndryshme të Shqipërisë, nëpër ekspozita theksohen edhe portrete piktorësh të rinj. Piktorët më shumë i adhurojnë portretet e fshatarit dhe fshatares shqiptare, që paraqiten me veshje të bukura. Piktorët, kështu, e kanë përjetësuar në krijimet e tyre një pjesë të jetës së tanishme të Shqipërisë.

As nuk mund të flitet për art të zhvilluar skulpture në Shqipëri. Mbreti Zog angazhohet që të rinjtë e talentuar t'i kryejnë sa më shpejtë studimet jashtë shtetit dhe të krijojnë art të veçantë kombëtar në skulpturë. I gjithë populli shqiptar shpreh shumë interesim për muzikën. E kam theksuar se shqiptarët adhurojnë radion. Kjo është gjë e rrallë për popujt që me shekuj kanë jetuar në atmosferë orientale. Për shembull, në Turqi radioja ende nuk pëlqehet nga masa.

Populli në Shqipëri e adhuron këngën dhe muzikën instrumentale, kurse koncertet janë të shpeshta në qarqe të ndryshme. Princeshat, motrat e Mbretit, që angazhohen aq shumë për gjallërimin e jetës shoqërore dhe kulturore, japin kontribut të madh edhe në sferën e muzikës. Përpjekjet e tyre përcillen me suksese.

Të huajt në Shqipëri

Shqipëria është vendi evropian që kudo ofron mundësi për ditë të qeta e të bukura. Në planin shpirtëror e politik ajo e përjetoi fatin më të keq dhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ka shënuar përparim të vërtetë. Sot Shqipëria hapëron rrugës së zhvillimit të fuqishëm, në të gjithë drejtimet, duke zgjuar interesimin e Europës. Të huajt po e vizitojnë Shqipërinë gjithnjë e më shumë. Ata interesohen për rregullimin e saj, për të kaluarën dhe punët që bëhen për ripërtëritjen e vendit. Pasi Shqipëria është plot me përmendore të pazbuluara nga e kaluara e largët, shumë studiues të huaj, veçanërisht arkeologët, vijnë shpesh në Shqipëri për të bërë me muaj hulumtime shkencore. Mund të thuhet, pa tepri, gjatë viteve të fundit Shqipëria është bërë një qendër studimesh arkeologjike jo vetëm në Europë, por edhe në botë. Sepse oferta e Shqipërisë, në këtë drejtim, çmohet më shumë se hulumtimet arkeologjike në Egjipt.

Përktheu Salajdin SALIHU

NUMRI I ARDHSHEM ME 10 SHKURT

HEJZA

01 SHKURT, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtore: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000